



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

**RAPORT STUDIMOR PËR VEPRAT PENALE
TË KORRUPSIONIT DHE FORMAVE
TË SHPËRDORIMIT TË DETYRËS**

Tirane, 2014

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Të kontribuojmë në forcimin e zbatimit të ligjit për ndëshkueshmërinë e rasteve të korrupsionit”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) dhe mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëri e Hapur për Shqipërinë (Fondacioni Soros)



*Open Society Foundation for Albania
Soros Foundation
The concept of open society is based on the recognition that people act on imperfect knowledge and nobody is in possession of the ultimate truth.*

Përmbajtja e kërrij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Fondacioni Shoqëri e Hapur për Shqipërinë, Soros

Përgatitën publikimin për shtypshkrim: Ma.Av. Etilda Gjonaj (Saliu),
Drejtuese programi, KSHH

Ma.Av. Erida Skendaj, *Asistente programi, KSHH*

Botoi: Shtëpia Botuese Vllamasi

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen e autorit

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Komiteti Shqiptar i Helsinkit
Rr. Brigada e 8-te, Pallati “Tekno Projekt”
Shk 2 Ap 10, Tirana-Albania
Kutia Postare nr.1752
Tel: 04 2233671

Përmbajtja

1. HYRJE.....	5
2. STUDIM I LEGJISLACIONIT DHE I ZHVILLIMEVE TË TIJ PËR VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT DHE FORMAVE TË TJERA TË SHPËRDORIMIT TË DETYRËS	8
2.1 Kuptimi i korrupsionit dhe zhvillimi i tij historik	9
2.2 Korrupsioni në vështrimin juridiko – penal	11
2.3 Korrupsioni aktiv (gjyqtarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë)	13
2.4 Korrupsioni pasiv (mitëmarrja) i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë	15
2.5 Disa probleme kryesore juridike penale të tjera që dalin nga raport studimi	16
2.6 Penalizimi i veprave penale të korrupsionit	20
2.7 Ankimi i vendimeve në Gjykatën e Apelit	23
2.8 Rekurset në Gjykatën e Lartë	25
2.9 Opinionet e vlerësimet për korrupsionin në drejtësi	25
2.10 Masat parandaluese kundër korrupsionit	28
3. DISA GJETJE TË STUDIMIT TE VENDIMEVE TE GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE PER VENDIMET E VEPRAVE PENALE TE SHPERDORIMIT TE DETYRES DHE KORRUPSIONIT	30
3.1 Disa të dhëna sasiore mbi studimin e vendimeve gjyqësore	31
3.2 Masat e sigurisë personale për të pandehurit që janë studiuar vendimet	33
3.3 Të dhëna mbi rastet e gjykuara me gjykim të shkurtuar	36
3.4 Kohëzgjatja e gjykimit	38
3.5 Shkaqet e zvarritjeve të proceseve gjyqësore	40
3.6 Të dhëna mbi politikën penale të ndjekur për personat e gjykuar në vendimet e studiuara	41
3.7 Aplikimi i dënimeve alternative	42
3.8 Ankimi dhe rekursi	45
3.9 Argumentimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore si dhe qartësia e shkrimit të tyre .	47
4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	52
4.1 Përfundime	52
4.2 Rekomandime	54

1. Hyrje

Një shtet demokratik është i bazuar në ndarjen e pushteteve midis ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit. Gjyqësori duhet të jetë i pavarur me qëllim që të sigurojë që ekzekutivi dhe legjislativi të veprojnë brenda limiteve kushtetuese. Vetë fakti që gjyqësori gjykon për çështje korruptive kërkojnë një gjyqësor më të fortë dhe më të pavarur. Rrezik i madh konsiderohet influenca dhe presioni politik që mund të ushtrohet mbi gjyqësorin sidomos në rastet kur gjyqtarët, prokurorët ndjekin çështje korrupsioni të zyrtarëve të lartë. Një ndër format më të përhapura të presionit është pikërisht emërimi i tyre sidomos të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese.

Influenca të tilla të gabuara mund të udhëheqin parimet e demokracisë si shtetin e së drejtës, ndarja e pushteteve dhe respektimin e të drejtave të njeriut drejt korrupsionit.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit nisur nga ndryshimet e bëra në Kodin penal për shtimin e veprave penale si dhe me qëllim që të kontribuojë në rritjen e ndëshkueshmërisë së veprave penale që lidhen me korrupsionin ndërmori një studim të vendimeve gjyqësore për veprat penale të korrupsionit dhe formave të tjera të shpërdorimit të detyrës.

Komiteti i Helsinkit shpreh gatishmërinë e plotë për të bashkëpunuar e dhënë kontributin e tij në luftimin e korrupsionit dhe parandalimin e tij në sistemin e drejtësisë e posaçërisht në atë gjyqësor.

KSHH ka patur si qëllim të studiojë jo vetëm se si janë gjykuar çështjet e korrupsionit dhe format e shpërdorimit të detyrës, por dhe njëkohësisht politikën penale që është ndjekur në këto dispozita ashtu si dhe studimi i objektivitetit të gjykimit nga ana e gjyqtarëve dhe paraqitja e akuzës së prokurorisë.

Metodologjia kryesore që është ndjekur në këtë raport është studimi i rreth 370 vendimeve të formës së prerë të rrethit gjyqësor Tiranë duke përfshirë dhe vendimet e Gjykatës së Lartë për një periudhë kohore që nga viti 2007 – 2011. Metodologjia që u ndoq lidhur me përzgjedhjen e vendimeve fillimisht ishte përzgjedhja e atyre vendimeve të gjykatës që lidhen me dispozitat e Kodit Penal, konkretisht Neni 135, 164/a, 164/b, 244, 245, 245/1, 248, 258, 259, 260, 319, 319/a.

Për shkak të shkallës së vështirësisë së studimit të këtyre vendimeve, u përgatitit një pyetësor dhe një strukturë me çështjet kryesore që u monitoruan. Studimi i vendimeve u krye falë angazhimit profesional të ekspertëve, znj. Enida Shameti, znj. Eva Dyrmishi dhe z. Hipokrat Biba, dhe z. Florian Xhiani i cili përgati dhe përmbledhjen e raporteve të ekspertëve për të cilët japim falenderimet më të përzemërta. Ekspertët u këshilluan gjatë gjithë periudhës nga Drejtorja Ekzekutive znj. Vjollca Meçaj dhe nga stafi i programit të KSHH-së „Reforma ligjore dhe Institucionale, aksesit i qytetarëve në organet e drejtësisë dhe zgjedhje të lira e të ndershme“, z. Niazi Jaho, znj. Etilda Saliu dhe znj. Erida Skendaj.

Ekspertët paraprakisht u informuan dhe u trajnuan jo vetëm me çështjet kryesore ligjore lidhur me këtë çështje por dhe me metodologjinë e studimit të vendimeve. Ekspertët u angazhuan jo vetëm në mbledhjen dhe unifikimin e statistikave për veprat penale të korrupsionit dhe format e tjera por njëkohësisht dhe në studimin dhe krahasimin e treguesve cilësorë të vendimeve gjyqësore për çështje të njëjta ose të ngjashme.

Një ndër elementët kryesore që u mbajt parasysh gjatë kryerjes së këtij studimi ishte studimi i politikës penale që është ndjekur gjatë kësaj periudhe për këto vepra penale të cilat bazuar nga dispozitivi kanë një rrezikshmëri mesatare.

Të gjitha të dhënat statistikore dhe gjetjet nga studimi i vendimeve si dhe studim i legjislacionit penal u prezantua para aktorëve kryesore në një tryezë të rrumbullakët ku u dhanë dhe kontributet përkatëse

të përfshira dhe si konkluzione dhe rekomandime në këtë raport studimor.

Studim i legjislacionit dhe i zhvillimeve të tij për veprat penale të korrupsionit dhe formave të tjera të shpërdorimit të detyrës të parashikuara në kapitullin e dytë u përgatitën nga Prof. Dr. Ismet Elezi, të cilën gjejmë rastin ta falenderojmë.

Përgatitja e raportit përfundimtar për gjetjet dhe konkluzionet e studimit të vendimeve gjyqësore u realizua nga Ma.Av.Etilda Saliu Gjonaj, Drejtuese programi KSHH.

Gjejmë rastin të falenderojmë dhe Fondacionin për Shoqërinë e Hapur – Shqipëri – SOROS për mbështetjen që na ka dhënë.

2. STUDIM I LEGJISLACIONIT DHE I ZHVILLIMEVE TË TIJ PËR VEPRAT PENALE TË KORRUPSIONIT DHE FORMAVE TË TJERA TË SHPËRDORIMIT TË DETYRËS

Iniciativa e Komitetit të Helsinkit për raport studimin e vendimeve penale të Gjykatës së Rrethit Tiranë, të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës së Lartë në fushën e korrupsionit meriton të përshëndetet.

Analizat cilësore të grupeve të ekspertëve shërbejnë si bazë për të bërë disa përgjithësime, konkluzione e rekomandime të dobishme për sistemin e drejtësisë.

Kriminalizimi dhe penalizimi i korrupsionit janë të një rëndësie të veçantë po të mbahet parasysh se ky fenomen është bërë shqetësues dhe nevojat e praktikës, diktojnë luftimin e rreptë të tij.

Veç asaj, ky detyrim buron edhe nga organizmat ndërkombëtarë, të cilët kanë vënë në dukje se korrupsioni në Shqipëri është përhapur dhe se lufta kundër tij merr prioritet të madh, si kusht për integrimin në Bashkimin Europian.

Mjafton të përmendim progres raportin e fundit të Komisionit Europian dhe të Parlamentit Europian ditët e fundit që i kushtojnë vendin kryesor luftimit të korrupsionit, posaçërisht në sistemin gjyqësor.

Për këtë arsye raport studimi është në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur, pa pretenduar se është i përkryer dhe i plotë. Studime të tilla kërkojnë të vihen në funksionim e drejta penale, procedura penale, kriminologjia, politika penale, penologjia, për të arritur në përfundime e rekomandime të rëndësishme, por këto janë objekt i instituteve të posaçme të kriminologjisë në vendin tonë.¹

¹ Elezi, I. Elezi, E. *Historia e së drejtës penale*, Tiranë 2010

Hysi, V. *Kriminologjia*, Tiranë 2010

Gjonaj, L. *Kriminologjia*, Tiranë 2013

Natyrisht, strategjia e re kombëtare që po përgatitet për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit do të shtrojë një bazë të rëndësishme për një bashkëpunim e bashkëveprim të organeve shtetërore me shoqërinë civile e me publikun.

2.1 Kuptimi i korrupsionit dhe zhvillimi i tij historik

Korrupsioni si fenomen historik e shoqëror i njohur që në lashtësi, 15-20 shekuj para e.r. si në Egjipt, Mesopotami, Babiloni, Asiri etj. Shfaqet edhe në kohën e sotme në shkallë ndërkombëtare, përfshirë Shqipërinë.

Nocioni i korrupsionit buron nga gjuha latine – folja “*corrumpere*”, që do të thotë të thyesh, të prishësh, të dëmtosh, të shkatërrosh, moralin, ndërgjegjen e një personi në marrëdhënie me një tjetër që kryen një detyrë apo funksion publik. Në të vërtetë nocioni i korrupsionit ka pësuar evolucionin e tij gjatë shekujve.

Filozofi dhe oratori i madh romak Ciceroni, ka vënë në dukje shkallëzimin e përhapjes së korrupsionit dhe natyrën e korrupsionit e shikonte te qenia dhe vetëdija e njeriut si dhe te prania e veseve njerëzore, dmth. i jep një shpjegim psikologjik.²

Në të drejtën romake për herë të parë ndeshim një ligj të përpiluar posaçërisht për korrupsionin dhe përdorimin e fjalës korrupsion.

Në mesjetë Nikola Makiaveli, korrupsionin e përcaktonte si një të keqe shtetërore, në bazë të së cilës qëndron shfrytëzimi i mundësive publike për interesa private. Ky përcaktim sot përbën thelbin e pjesës më të madhe të përkufizimeve që i japin shkencëtarët apo organizmat ndërkombëtare këtij fenomeni.

Kështu, në kohën e sotme psh. ITAP shprehet se: “Korrupsioni është shpërdorimi i pushtetit të marrë me delegim për qëllime private”.

² Aliu, E. E drejta penale romake në fjalimet gjyqësore të Ciceronit, Tribuna Juridike n.55/2005, f.121-126

Të tjerë autorë e konsiderojnë korrupsionin në formën e marrëveshjes të një personi në detyrë me funksione publike për të siguruar përfitime materiale ose përfitime të tjera me interes personal dhe të atij që e merr atë përfitim.

Sipas Konventës penale “Për korrupsionin” të Këshillit të Europës si akti juridik kryesor i ratifikuar nga shteti shqiptar, fjala “korrupsion” merr kuptimin e të kërkuarit, ofrimit, dhënies dhe pranimit drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë të një mjeti apo të çdo lloj tjetër avantazhi apo përfitimi që deformon kryerjen e çdo detyre ose sjellje për të kërkuar nga pranuesi i mitëmarrjes për pasoje dhe të avantazhit e përfitimit të padrejtë”. Ky përkufizim është pasqyruar edhe në Kodin tonë penal.

Në kohën e sotme janë të shumtë autorët e huaj që trajtojnë gjerësisht kuptimin dhe format e korrupsionit deri te “shitblerja totale e nëpunësve shtetërorë”, siç shprehet studiuesi amerikan B.Reisman.

Pavarësisht nga diversiteti i opinionëve e përkufizimeve ekzistojnë elemente thelbësore të përbashkëta – dhënie e marrje të përfitimit material (ryshfetit, mitës).

Me krijimin e funksionimit e organizmave të vetqeverisjes vendore, korrupsioni edhe në Shqipëri filloi të dënohej administrativisht e më pas penalisht. Kështu në Statutet e Shkodrës (fillimet e shek.XIV) parashikohet si vepër penale marrja e të hollave nga gjyqtari për një gjyq dhe dënimi me gjobë e me largimin e tij përgjithmonë nga detyra e gjyqtarit.³ (kreu IX)

Edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit parashikohet shprehimisht “Ndoni plak se e banë gjyqin me krahëmbajtje a kundra Kanunit veçse pse i thyem prej nëndorjeve t’anës kundërshtare, veç faqes së zezë, s’e merr kush ma për plak” (paragrafi 1016).⁴

³ Elezi, I. Statutet e Shkodrës, dhjetor 2003

⁴ Gjeçovi, Sh. Kanuni i Lekë Dukagjinit, Shkodër 1933

Që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptar dhe deri në ditët e sotme, korrupsioni dënohet penalisht dhe për më tepër edhe moralisht, si i papajtueshëm me ligj dhe me moralin e shoqërisë shqiptare në shtetin e së drejtës.

2.2 Korrupsioni në vështtrimin juridiko – penal

Krimi i korrupsionit godet rëndë interesat ekonomike të njerëzve, moralin e ndërgjegjen e tyre, autoritetin e drejtësisë dhe besimin e popullit ndaj saj, funksionimin e rregullt të shtetit të së drejtës, demokracinë, sistemin financiar e deri te siguria kombëtare e vendit (neni 217).

Në vitin 2013, sipas Transparency International, Shqipëria u klasifikua si vendi më i korruptuar në Europë, zuri vendin e 116 nga 113 që ishte një vit më parë.⁵

Edhe në Progres raportin e Komisionit European për vitin 2013 theksohet forcimi i luftës kundër korrupsionit si detyrë kryesore e shtetit shqiptar.

Pikërisht për këto arsye del në plan të parë luftimi në mënyrë të vendosur i këtij fenomeni negativ dhe marrja e masave të gjithanshme për parandalimin e tij.

Në luftimin e tij armë e fuqishme efektive është edhe legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë, i cili, në harmoni me Konventat dhe Rekomandimet e ndërkombëtarëve, parashikon kriminalizimin e veprave penale të korrupsionit dhe penalizimin e tyre me sanksionet penale, bazuar në parimet e ligjshmërisë e të fajësisë, të përgjegjësisë penale, të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në luftimin e kriminalitetit.

Ky legjislacion në lidhje me kriminalizimin dhe penalizimin e korrupsionit ka pësuar gjatë periudhës së tranzicionit evolucionin e

⁵Gazeta shqip 3 dhjetor 2013

tij, duke u plotësuar e ashpërsuar vazhdimisht dënimin.

Pas kalimit të Shqipërisë në pluralizmin politik, në vitin 1995 doli Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Në kod parashikoheshin vetëm dy figura krimi të korrupsionit: a. Kërkimi për mitëmarrje (neni 259) dhe b. Marrja e mitës (neni 260).

Mitëdhënia nuk parashikohej si krim me motivacionin se personi që jepte mitë nuk mund të denonconte vetveten. Kufizimi i kriminalizimit vetëm te dy vepra penale të korrupsionit nuk ishte efektiv për luftimin e tij, derisa në këtë krim ka marrëveshje midis mitëmarrësit e mitëdhënësit, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë duhen dënuar si mitëmarrësi, ashtu dhe mitëdhënësi.

Këto mangësi u plotësuan me reformën ligjore të vitit 2004, me ligjin nr. 9275 datë 16.09.2004, bazuar në Konventën Penale për korrupsionin të Këshillit të Europës (Strasburg 1999), ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8778 datë 26.04.2001.

Me këtë ligj u bë unifikimi i terminologjisë me atë të Konventës, duke zëvendësuar termin marrja e mitës me termin “korrupsion pasiv” dhe të mitëdhënies me termin “korrupsion aktiv” nën ndikimin e globalizmit në gjuhën ligjore sepse populli synë një fjalët “ryshfet” apo “nëndore”.

Por më kryesorja ishte se me ligjin e vitit 2004 u kriminalizuan vepra të reja penale të korrupsionit aktiv e pasiv në sektorin privat (neni 164); korrupsioni aktiv e pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike (nenet 244 e 259); korrupsioni i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë (nenet 245 e 260); korrupsioni aktiv e pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë.

Në mbështetje të Protokollit shtesë të Konventës Penale dhe të rekomandimeve të grupit të shteteve kundër korrupsionit (GRECO),⁶ në vitin 2012, me ligjin nr. 23 datë 1.3.2012, u bënë shtesa e ndryshime të tjera në Kodin Penal për kriminalizimin e penalizimin e veprave penale të korrupsionit aktiv e pasiv për gjyqtarët e gjykatave ndërko-

⁶ Akte juridike Ndërkombëtare, Tiranë 2006

mbëtare, jurive, arbitrit të vendit e të huaj (nenet 319/a deri 319/e).

Aktualisht Kodi Penal përmban 21 nene që kriminalizojnë e penalizojnë veprat penale të korrupsionit, kurse Konventa Europiane 13 nene (11 nga të cilat janë nën variante të tyre).

Nga paraqitja e sipërme rezulton se shteti ynë ka realizuar në mënyrë të kënaqshme përafrimin e legjislacionit penal me Konventën Penal të Këshillit të Europës dhe me rekomandimet e GRECO-s për luftimin e korrupsionit aktiv e pasiv.

Këto shënojnë arritje pozitive në reformën ligjore. Megjithatë jemi larg standardeve europiane në ligjëbërje. Studiuesi gjerman Heinz Zipf thekson se: “Në fushën penale nuk tolerohen ndërhyrje të shpejtuara, të pakonsultuara dhe të vlefshme për një kohë të shkurtër. Politika kriminale kërkon perspektiva për një afat të mesëm e të gjatë”.⁷

Në Kodin tonë janë bërë mbi 250 shtesa e ndryshime të shpeshta, përfshi nenet për korrupsionin.⁸ Shumica prej tyre janë marrë mekanikisht pa u studiuar e konsultuar. Mjaft nga nenet për korrupsionin mund të ishin përmbledhur. Kodi Penal italian ka vetëm 5 nene, KP i Kosovës – 2 nene. Në formulimin e tyre nuk është respektuar teknika ligjore.

Në Kod nuk janë përfshirë rrethanat rënduese të korrupsionit – i kryer nga një grup i strukturuar, me shtrëngim, në përpjestime të mëdha. Le të shpresojmë që në Kodin Penal të ri, i cili është nevoja të përgatitet, të plotësohen.

2.3 Korrupsioni aktiv (gjqytarit, prokurorit dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë)

Në raport studimet e vendimeve penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës së Lartë, analizohet veprimtaria e tyre në gjykimin e veprave penale të

⁷ Zipf, H. *Politica criminale*, Giuffrè editore, Milano 1989, f.320

⁸ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë 1995 me ndryshime.

korupsionit, por nuk bëhet fjalë për vetkorupsionin e gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë.

Për këto arsye e shoh të domosdoshme që të ndalem edhe në këtë aspekt jo më pak të rëndësishëm të luftimit kundër korupsionit sepse është shumë aktual dhe shqetësues për shoqërinë e shtetin tonë si dhe për opinionin ndërkombëtar, i cili shprehet për korupsionin në drejtësi.

Në një anketim gjyqësor të realizuar nga Qendra për Transparencë dhe Informacionin e lirë në bashkëpunim me Ambasadën Britanike në të cilin u përfshinë 68% e gjyqtarëve të shkallës së parë në të gjithë vendin (14 nga 29 gjithsej) ku morën pjesë 58% ose 117 gjyqtarë nga 305 që janë gjithsej janë dhënë këto përgjigje: 25% e gjyqtarëve kanë thënë se gjyqësori në Shqipëri është i korruptuar. Rreth 58% mendojnë se korupsioni është vetëm perceptim, ndërsa 18% e shikojnë sistemin e drejtësisë jo të korruptuar.⁹

Për të mbrojtur autoritetin e pushtetit gjyqësor e të gjyqtarëve e prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë si dhe moralin e interesat e shtetasve, Kodi Penal, pas reformave ligjore 2004-2013 parashikon kriminalizimin e veprave penale të korupsionit aktiv e pasiv (në nenet 319 e në vijim), me përmbajtje si vijon:

Premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, për vete ose për persona të tjerë, gjyqtarit, prokurorit ose çdo punonjësi tjetër të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën a funksionin e tij, dënohen me burgim nga një vit deri në katër vjet. (neni 319)

Me këtë dispozitë penale vihen në mbrojtje të posaçme ligjore jo vetëm veprimtaria e rregullt dhe e ndershme e gjyqtarëve, prokurorëve ose funksionarëve të tjerë të drejtësisë, por edhe të drejtat e interesat e shtetasve, që të mos japin të holla (mitë) ose përfitime të tjera për zgjidhjen e çështjeve të tyre gjyqësore.

Sipas nenit 319 të Kodit Penal vepra penale e korupsionit aktiv nga ana objektive kryhet edhe atëherë kur mitëdhënësi i jep të hollat apo përfitim të parregullt të drejtpërdrejtë por edhe tërthorazi, psh. i

⁹ Gazeta Shqiptare date 24 tetor 2012, nr. 14

jep shoferit të gjyqtarit a të prokurorit të holla apo përfitime të tjera materiale për t'ia dhënë gjyqtarit a prokurorit për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me detyrën a funksionin e tij (psh. të pushojë çështjen, apo të ndryshojë cilësimin juridik të veprës penale në favor të të pandehurit).

Për korrupsionin aktiv të gjyqtarit apo prokurorit ose punonjësit tjetër të drejtësisë ka përgjegjësi penale ai person (subjekt i veprës penale që premtion, propozon ose jep një përfitim të parregullt). Në këtë kuptim bëhet kriminalizimi dhe penalizimi i mitëdhënësit (personit – subjekt i përgjithshëm i korrupsionit aktiv).

Sipas raport studimit të vendimeve penale të gjykatave në Tiranë rezulton se nuk është dënuar asnjë person që ka dhënë mirë (për korrupsion aktiv) sepse këta ose nuk janë zbuluar nga policia ose nuk janë marrë si të pandehur. Një praktikë e tillë është e gabuar dhe e dëmshme – e kundërligjshme sepse favorizon përhapjen e korrupsionit aktiv e jo kufizimin e luftimin e tij.

2.4 Korrupsioni pasiv (mitëmarrja) i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë

Me ligjin nr. 9275 datë 16.09.2004 në Kodin Penal u shtua neni 319/ç me këtë përmbajtje:

Kërkimi ose marrja, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë, për vete ose për persona të tjerë, ose pranimi i një oferte a premtimi, që vjen nga përfitimi i parregullt, nga gjyqtari, prokurori ose funksionarë të tjerë të organeve të drejtësisë, për të kryer ose mos kryer një veprim që lidhet me detyrën e funksionin e tij, dënohen me burgim nga tre deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga tetëqind mijë deri në katër milionë lekë. (neni 319/ç)

Krimi i korrupsionit pasiv i gjyqtarit, prokurorit apo funksionarëve të tjerë të drejtësisë ka për objekt moralin, ndërgjegjen dhe sigurinë e veprimtarisë së rregullt e të ndershme të gjyqtarëve, prokurorëve e të funksionarëve të tjerë të drejtësisë si dhe të drejtat e interesat

ekonomike të ligjshme të shtetasve të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Edhe nga ana objektive krimi i korrupsionit pasiv të kategorive të personave që u përmendën më lart, ka elemente të përbashkët në formë e në përmbajtje me korrupsionin aktiv të tyre. Dallimi kryesor i këtyre dy figurave të veprave penale (neni 319 e 319/a) qëndron te subjekti i veprës penale, sepse në rastin e korrupsionit pasiv është subjekt i posaçëm (gjuqtari, prokurori apo funksionarët e tjerë të drejtësisë).

Në kuptimin e gjuqtarit hyjnë gjuqtarët e shkallës së parë, të Gjykatës së Apelit, të Gjykatës së Lartë dhe në kuptimin e prokurorit – prokurorët e rretheve gjyqësore.

Përsa u përket funksionarëve të tjerë të drejtësisë meqënëse nuk janë përcaktuar në fjalorin terminologjik, lë të kuptohen ata që kanë detyra në këto organe (sekretari i përgjithshëm, kancelari, drejtorët e departamenteve e deri te sekretarët e gjykatave) (shembulli i Pukës).

2.5 Disa probleme kryesore juridike penale të tjera që dalin nga raport studimi

a. Problem i rëndësishëm që shtrohet në raportet e studimit të vendimeve penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është ai i **mosanalizës së të gjithë elementëve të figurës së veprës penale të korrupsionit** në lidhje të ngushtë me çështjen objekt gjykimi. Analiza e elementëve përbërës të figurës së veprës penale është e domosdoshme për të arritur në përfundim nëse i pandehuri ka përgjegjësi ose jo dhe për cilësimin juridik të drejtë të veprës penale si dhe për caktimin e dënimit.

Elementët thelbësorë të figurës së veprave penale të korrupsionit janë të përbashkët, por çdo figurë e veprës penale ka edhe veçoritë e saj.

Objekti (sendet) që jepen dhe merren në korrupsionin aktiv e pasiv mund të jenë të ndryshme, me vlera ekonomike. Këtu hyjnë paratë, çeku, letrat me vlerë, sende të tjera me vlerë, bileta transporti, shërbime të ndryshme, si transporti i mallrave, dhënia e apartamenteve për

banim pa qera apo dhurimi. Në literaturë diskutohet nëse hyjnë në objekt të korrupsionit diplomat, librezat e punës etj. Nisur nga fakti se me diploma të universiteteve private furnizohen jo vetëm shqiptarë, por edhe të huaj jam i mendimit se nuk ka vend për diskutime, por të pranohen si objekt i korrupsionit.

Ndër elementët përbërës të figurës së veprës penale të korrupsionit ka rëndësi sqarimi i anës objektive–mënyra se si është kryer korrupsioni, me veprime aktive ose mosveprime, nëse përfitimi material është dhënë e marrë para ose pas kryerjes se favorit në interes të mitëdhënësit. Me rëndësi është sqarimi i pasojave nëse janë të rënda ose jo, si dhe lidhja shkakësore. Nga raport studimi rezulton se në vendimin nr. 679 datë 30.04.2012 në çështjen e korrupsionit në sektorin privat nuk është sqaruar lidhja shkakësore dhe i pandehuri është dënuar.

Jo më pak rëndësi ka sqarimi dhe saktësimi i subjektit të veprës penale të korrupsionit pasiv sepse janë subjekte të posaçëm. Veç këtyre të analizohet nëse ka bashkëpunëtorë, kush ka qenë ndërmjetës.

Në rast se një person merr të holla nga një tjetër për t'ia dhënë gjyqtarit apo prokurorit dhe i përvetëson, ky përgjigjet për mashtrim, kurse mitëdhënësi për tentativë të plotë të korrupsionit aktiv.

Elementi tjetër – ana objektive – të saktësohet në vendim se këto vepra penale kryhen me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim përfitimi material.¹⁰

Paraqitja e elementëve të figurës së veprës penale pa e lidhur organikisht me faktin që përbën veprën penale që gjykohet është formale dhe nuk ka vlera praktike. Vetëm duke e ndërlidhur ngushtë me objektin e gjykimit ka efektivitetin e kërkuar dhe vërtetohet se i pandehuri ka kryer ose jo veprën penale të korrupsionit dhe bazohet përgjegjësia penale e tij.

b) Mbi bazën e kësaj analize të elementëve përbërës të figurës së veprës penale bëhet cilësimi juridik i drejtë e i saktë i

¹⁰ Elezi, I. E drejta penale (pjesa e posaçme) 2009

veprës penale shërben për të bërë dallimin posaçërisht kur ka konkurim apo vepra penale të përafërta, si psh. korrupsioni me shpërdorimin e detyrës.

Nga raport studimet e vendimeve penale të gjykatave në Tiranë jepen jo pak shembuj të zbatimit e interpretimit të ndryshëm të neneve të Kodit Penal lidhur me korrupsionin e posaçërisht për dallimin e korrupsionit nga shpërdorimi i detyrës dhe për pasojë kanë sjellë ndryshime në cilësimin juridik të veprave penale në dënimin e të pandehurit.

Kjo çështje nuk ka karakter formalo – juridik, por përkundrazi është me karakter parimor për sundimin e ligjit, dhënien e drejtësisë, mbrojtjen e të drejtave e lirive të njeriut, sidomos të personave të pandehur.

Dallim i krimit të korrupsionit nga ai i shpërdorimit të detyrës është bërë i qartë në doktrinën e së drejtës penale (pjesa e posaçme) për çdo jurist. Këto figura krimi janë më vete, por kur shpërdorimi i detyrës shoqërohet me korrupsion atëherë kemi konkurim të tyre.

Në veprën penale të shpërdorimit të detyrës, personi që ushtron funksione publike kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta, vepron në kundërshtim me ligjin. Ndërsa në veprën penale të korrupsionit pasiv personi kërkon ose merr përfitime për të kryer ose mos kryer një veprim që ka lidhje me detyrën por nuk vepron në kundërshtim me detyrën e tij.

c) Problemi tjetër kyç në lidhje me korrupsionin është moszbatimi i rregullt i ligjit penal dhe posaçërisht pandëshkueshmëria e krimit të korrupsionit sidomos ndaj funksionarëve të lartë të drejtësisë, si dhe të shtetit në përgjithësi.

Shkaqet dhe faktorët që veprojnë në këtë drejtim janë të ndryshëm, me karakter objektiv e subjektiv.

Moszbatimi i ligjit dhe pandëshkueshmëria e veprës penale lidhen me faktorët subjektivë që nga paaftësia profesionale e gjyqtarit apo prokurorit, nga mosnjohja e ligjit apo interpretimi i gabuar i dispozitës

përkatëse, për shkak të kolizionit të dispozitave të ndryshme dhe kontradiktat midis tyre.

Shtesat e ndryshimet në Kodin Penal janë të shumta e të shpeshta, kështu që njohja e kuptimi i tyre është i domosdoshëm. Kjo arrihet me leximin e literaturës juridike, të vendit e të huaj, të komentareve, nëpërmjet trajnimeve të organizuara në bashkëpunim me fakultetet e drejtësisë. Nuk mund të arrihen standardet europiane me bagazhin e kulturës juridike të Fakultetit apo edhe të Shkollës së Magjistraturës, kërkohet profesionalizëm i lartë, kualifikim e studim i vazhdueshëm, kulturë juridike e mirëfilltë europiane.

Moszbatimi i rregullt i ligjit dhe pandëshkueshmëria e veprës penale janë rezultat i presioneve politike sidomos kur është fjala për funksionarë të lartë të akuzuar për korrupsion, fenomen ku i ndeshur jo rrallë në praktikë.

Pandëshkueshmëria mund të jetë pasojë e ndërhyrjeve të jashtme të të afërmeve, të njohurve, miqve, shokëve që ndërmjetësojnë te gjyqtari apo prokurori të pushojnë çështjen apo të japin pafajësi këto në shoqërinë shqiptare si vend i vogël e me lidhje të shumasnshme, reflektojnë shumë në dhënien e drejtësisë nga gjykata sidomos kundër të pandehurve për korrupsion, rrjedhimisht në pandërshkueshmërinë.

Në dhënien e drejtësisë nga gjykata, siç vëren dr. Sokol Sadushi, ish anëtar i Gjykatës Kushtetuese me përvojë: “Janë cilësitë e gjyqtarëve, si profesionalizmi, qëndrueshmëria e parimeve morale, karakteri me virtyte të pakorruptuara, veçanërisht në lidhje me të vërtetën dhe korrektësinë, i bën ata të pathyeshëm ndaj çfarëdo sulmi të kontribuojnë në cilësinë e vendimmarrjes dhe në vetë pavarësinë e gjykatës”.¹¹

¹¹ Sadushi, S. Rëndësia që paraqet procesi i përzgjedhjes së gjyqtarëve të gjykatës së lartë dhe asaj kushtetuese, si busull orientuese për praktikën gjyqësore dhe drejtësinë kushtetuese. A paraqitet i plotë kuadri ligjor në këtë drejtim? Sfida dhe realitete. Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë: Kumtesa dhe konkluzione të Konferencës, 4 maj 2012

Natyrisht duke vënë në dukje disa faktorë që lidhen drejtpërdrejt me pushtetin gjyqësor në luftimin e korrupsionit do të kemi parasysh se faktori vendimtar është vullneti politik, serioz, efektiv i pushtetarëve.

Ky faktor shoqërohet e vë në lëvizje edhe faktorët e tjerë që u theksuan më lart, si dhe me faktorët organizative, edukues të trajnimit të gjyqtarëve, prokurorëve etj.

2.6 Penalizimi i veprave penale të korrupsionit

Politika penale kundër korrupsionit si shfaqje e politikës shtetërore, realizohet jo vetëm nëpërmjet kriminalizimit të veprave penale të tij, por edhe me anë të penalizimit të tyre nëpërmjet zbatimit të sanksioneve penale, bazuar në individualizimin e dënimit dhe të rehabilitimit e risocializimit shoqëror të personave të dënuar.¹²

Sanksionet penale të parashikuara në Kodin Penal për llojet dhe format e korrupsionit pa përjashtim janë me burgim që arrin deri në dymbëdhjetë vjet për disa figura krimi (parashikohej edhe gjoba, por është hequr si dënim kryesor).

Kështu, korrupsioni aktiv në sektorin privat dënohet me burgim nga tre muaj deri në dy vjet, kurse për korrupsionin pasiv nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet, ndërsa korrupsioni pasiv dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet. Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë me burgim nga një deri në pesë vjet, kurse korrupsioni pasiv dënohet me burgim nga katër deri në dymbëdhjetë vjet. Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë dënohet me burgim nga një deri në katër vjet, kurse korrupsioni pasiv i tyre dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

Sanksionet penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë për korrupsionin krahasuar me disa kode penale të shteteve të huaj (Itali e deri Kosovë), janë pak a shumë të përafërta me përjashtim të

¹² Latifi, V. Elezi, I. Hysi, V. Politika e luftimit të kriminalitetit, Prishtinë 2012

korruptionit pasiv të funksionarëve të lartë publikë, gjyqtarëve, prokurorëve, për të cilët Kodi ynë penal parashikon dënime më të rënda.

Në dallim nga sanksionet që parashikon Kodi Penal për veprat penale të korruptionit, praktika gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë u ka dhënë përparësi dënimeve mesatare. Në parim, duke marrë për bazë rrezikshmërinë e madhe të korruptionit dhe shkallën e përhapjes së tij, një politikë e tillë e mesatares nuk mund të ketë efektivitetin e duhur, veçanërisht për korruptionin pasiv të funksionarëve të lartë publikë, gjyqtarëve e prokurorëve.

Kjo, natyrisht nuk mund të interpretohet se në çdo rast gjykata duhet të zbatojë maksimumin e dënimit me burgim. Kriteret ligjore të caktimit të dënimit janë të përcaktuara në ligj dhe bindja e brendshme e gjyqtarit formohet gjatë procesit gjyqësor nga vlerësimi i provave dhe personalitetit të të pandehurit duke bërë individualizimin e dënimit.

Për korruptionin aktiv mund të jenë të pranueshme e të përshtatshme dënimet alternative. Për korruptionin pasiv të ndiqet një politikë penale më efektive, me burgim.

Nga vendimet gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitet 2011 – 2012 rezulton se nuk ka qëndrim të unifikuar në vlerësimin e rrezikshmërisë shoqërore të krimit të korruptionit. Në disa vendime rrezikshmëria vlerësohet e lartë, në disa të tjera nuk ka rrezikshmëri të madhe. Në bazë të këtij vlerësimi caktohet edhe dënimi. Në çdo rast korruptioni, posaçërisht korruptioni pasiv paraqet rrezikshmëri të madhe dhe kjo shërben për caktimin e dënimit.

Në përgjithësi gjykata në caktimin e dënimit ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese e rënduese që parashikon ligji. Vërejtje bëhet për ato vendime, në të cilat dënimi është caktuar pa patur parasysh dëmin e madh që i është shkaktuar shtetit.

Kështu në vendimin nr.711 datë 19.05.2008, në çështjen penale për kryerjen e veprimeve korruptive për prokurimin e fondeve publike për investime me objekt ndërtimin e disa rrugëve publike, për të cilën ishin marrë të pandehur disa funksionarë të lartë të Ministrisë së

Transporteve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, duke shkaktuar dëme të mëdha financiare, në vendim nuk analizohet në caktimin e dënimit vlera e përfituar nga veprimet korruptive (150 mijë euro për secilin prej tyre).

Dënimet alternative. Sipas raport studimit në praktikën e Gjykatës së Tiranës është zbatuar dënimi alternativ (neni 59) – pezullimi i ekzekutimit të vendimit (burgim – vënia në provë), detyrim për t'u paraqitur në prokurori, të mos ushtrojnë funksione publike, të mos ushtrojnë detyrë drejtuese dhe pezullim i ushtrimit të funksionit të avokatit.

Sipas mendimit tonë do të ishte e përshtatshme që për krimin e korrupsionit pasiv, veç dënimit me burgim, si rregull, të jepet më shpesh dënimi i heqjes së të drejtës për të ushtruar profesionin apo detyrën në drejtësi. Këtë politikë penale pak a shumë ka ndjekur edhe gjykata e Tiranës dhe kjo mund të vazhdojë të ndiqet edhe në të ardhmen pa përjashtuar dënimet e tjera alternative.

Edhe pas ndryshimeve në Kodin Penal në vitin 2008, gjykata ka vazhduar të zbatojë nenin 59 të Kodit Penal – pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë. Nga të dhënat e Ministrisë së Drejtësisë në konferencën e fundit (tetor 2013) Shërbimi i Provës ka dhënë rezultate mjaft pozitive.

Si konkluzion i të dhënave të sipërme mund të nxiret se zbatimi i dënimeve alternative e posaçërisht pezullimi i ekzekutimit të vendimeve dhe vënia në provë, janë dënime të përshtatshme me efekte edukative, rehabilituese e risocializuese për të pandehurin e akuzuar për korrupsion aktiv dhe lehtëson barrën financiare të shtetit që t'i mbajë në burg këta të pandehur. Tendenca e zgjerimit të dënimeve alternative në vend të burgimit meriton të përkrahët më shumë dhe është në harmoni me filozofinë liberal – demokratike dhe me teorinë penale bashkëkohore të Mark Anselit (Francë) si dhe me rekomandimet e Këshillit të Europës. **Por për korrupsionin pasiv të funksionarëve të lartë publikë, gjyqtarëve e prokurorëve efektiv caktohet dënimi me burgim, sepse është krim i rëndë dhe i shkakton**

dëm të pallogaritshëm autoritetit të drejtësisë, ndërgjegjes e moralit të vetë gjyqtarëve e prokurorëve.

Dënimet plotësuese. Raport studimi i vendimeve penale për korrupsionin trajton edhe dënimet plotësuese (neni 30 i Kodit Penal) që ka aplikuar Gjykata e Tiranës – kanë qënë ndalimi për të ushtruar funksione publike për një periudhë të caktuar kohe.

Nga studimi i vendimeve është arritur në përfundim se nuk vërehet një qëndrim i njësuar i gjykatës për të zbatuar dënimin plotësues të ndalimit të ushtrimit të funksioneve publike për shkak të pozicionit dhe funksionit të tyre shtetëror – për zyrtarët e lartë (drejtorë, shefa sektorësh) ndërsa jepen për nëpunës të ulët – llogaritarë, inspektorë të tatimeve etj.

Gjykatat nuk argumentojnë domosdoshmërinë e dhënies së dënimeve plotësuese por mjaftohen me citimin e dispozitës përkatëse. Këto kriteret meritojnë të vlerësohen nga gjykatat, sepse dënimet plotësuese kanë efektivitet të madh po që se zbatohen kundër kategorisë së zyrtarëve të lartë, sepse ata kanë kryer funksione publike të rëndësishme dhe gjyqtarëve e prokurorëve sepse dëmi i shkaktuar prej tyre është më i rëndë.

Në këtë raport studimi thuhet se nuk ka patur përjashtime nga dënimi për rastet kur të pandehurit kanë bashkëpunuar me drejtësinë sipas nenit 245/2 të Kodit Penal.

Kjo praktikë ka vend të përmirësohet sepse ky nen është vënë për t’u zbatuar në praktikë sipas kriterëve ligjore të parashikuara në Kodin Penal dhe paraqet interes të madh për organet e ndjekjes penale, sidomos për zbulimin e korrupsionit dhe të bashkëpunëtorëve në korrupsion.

2.7 Ankimi i vendimeve në Gjykatën e Apelit

Raporti i studimit i kushtojnë vëmendje ankimit të vendimeve penale në Gjykatën e Apelit, e cila ka lënë ka lënë në fuqi disa prej tyre, kurse të tjerë i ka ndryshuar, ose i ka prishur dhe 1 e ka pushuar.

Për vendimet që janë lënë në fuqi është ndjekur e njëjta linjë argumentimi edhe përsa i përket vlerësimit të elementëve të figurës së veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit.

Sipas mendimit tonë, nga këto të dhëna dalin dy probleme të rëndësishme:

1. Ndryshimet e prishja e vendimeve penale nga Gjykata e Apelit janë relativisht shumë. Analiza e shkaqeve të ndryshimeve e të prishjeve nuk është e plotë dhe e qartë, nëse ka dyshime për korrupsion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë apo janë burim i paaftësisë profesionale në cilësimin juridik ose mosvlerësimin si duhet të provave dhe dhënia e drejtësisë e pabazuar në to.
2. Çështja tjetër ka të bëjë me cilësimin juridik të veprës penale. Gjykoj se Kolegji Penal i Apelit në dy vendime – vendimi datë 16.03.2012 dhe vendimi 916 datë 07.06.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vlerësoi drejt bërjen e dallimit ndërmjet elementëve të veprës penale të korrupsionit pasiv të parashikuar në nenin 259 të Kodit Penal nga krimi i shpërdorimit të detyrës (neni 248) duke u mbështetur plotësisht në doktrinën e së drejtës penale (pjesa e posaçme).

Është vepruar drejt edhe në interpretimin gjyqësor të nenit 164/b që bëhet në vendimin nr. 833 datë 14.06.2010 në lidhje me korrupsionin pasiv në sektorin privat, ku theksohet se nuk kërkon domosdoshmërisht që nga ana objektive i pandehuri të ketë kundërshtuar, marrë apo ofruar lekë, por parashikohet “kërkimi, marrja drejtpërdrejtë ose tërthorazi i çdo lloj përfitimi të parregullt”.

Me këtë rast kritikohet vendimi i Gjykatës Rrethit gjyqësor Tiranë se nuk jemi para veprës penale të korrupsionit pasiv në sektorin privat. Me të drejtë në raport studimin shtrohet pyetja: atëherë cili është interesi i të gjykuarës në falsifikimin e dokumentacionit të kredisë dhe e bashkëpunimit me një person, i cili ka përfituar të holla nga kreditë që kanë përfituar një numër i konsiderueshëm kredimarrësit. Këtu pikëpyetja për korrupsion mbetet në fuqi.

2.8 Rekurset në Gjykatën e Lartë

Sipas raport studimit është bërë rekurs për një numër vendimesh janë analizuar në Gjykatën e Lartë. Për shumicën e tyre është vendosur mospranim, 1 është lënë në fuqi dhe 1 është pushuar.

Fakti që shumica e vendimeve të ankimuara nuk janë pranuar nga dhoma e këshillimet tregon se ankimet kanë qenë të pabazuara dhe angazhojnë Gjykatën e Lartë në punë pa efektivitet. Kjo dëshmon për përgatitjen profesionale të pamjaftueshme të ankuesve ose keqpërdorim të avokatëve që bëjnë rekurse. Këta janë kompetentë dhe vlerësojnë se kur dhe ku mund të bëhet rekurs, si dhe të bindin ankuesit që nuk kanë baza ligjore për ankim të vendimit.

2.9 Opinionet e vlerësimet për korrupsionin në drejtësi

Në lidhje me opinionet e vlerësimet që janë shfaqur e shfaqen vazhdimisht nga organizmat e ndryshme ndërkombëtare dhe perceptimi i publikut shqiptar për korrupsionin në drejtësi, ka vend për debat e diskutime të bazuara në fakte.

Që të gjykosh për korrupsionin në drejtësi në tërësi dhe për pushtetin gjyqësor në veçanti, është e nevojshme të analizohet gjendja veç për prokurorinë, veç për gjykatën dhe veç për funksionarët e tjerë të drejtësisë. Ky dallim duhet bërë për shkak të veçorive të funksioneve publike dhe kompetencave që ka secili organ, si dhe të subjekteve të veçanta.

Arsyeja tjetër është te vëllimi i punës që përballon, natyra e saj që kryen secili prej këtyre organeve dhe mënyrat e metodat e kontrollit që ushtrohen mbi secilin prej tyre kanë veçoritë e tyre.

Veprimtaria hetimore e prokurorit i nënshtrohet kontrollit gjatë procesit të rregullt ligjor nga gjykata, veç kontrollit të brendshëm, kurse vendimet e gjykatës nga shkallët më të larta si dhe nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Jo më pak rëndësi ka edhe faktori i integritetit moral të prokurorëve, gjyqtarëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë si dhe profesionalizmi i tyre për ta vlerësuar në tërësi dhe në veçanti për çdo

organ e funksionar publik që punon në këto organe.

Dihet se strukturat dhe kompetencat e prokurorisë e të gjykatës e të funksionarëve të tjerë të drejtësisë janë caktuar me ligj.

Këto veçori reflektojnë edhe në opinionet për korrupsionin e prokurorëve e të gjyqtarëve. Më shumë flitet për këta të fundit, sepse gjyqtarët janë ata që marrin vendimin për çështjen që gjykohet.

E vërteta historike është se gjatë periudhës së pluralizmit politik gjykatat e prokuroritë kanë qenë objekt kryesor i sulmeve. Në rradhë të parë këto bëhen nga politika, nga media e nën ndikimin e saj të drejtpërdrejtë nga personat e dënuar të pakënaqur ose ata që kanë humbur gjyqin në çështje të tjera civile etj.

Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar e ndikojnë fuqishëm në imazhin negativ të publikut ndaj sistemit të drejtësisë. Po këta faktorë e posaçërisht faktori politik i brendshëm vepron në formimin e imazhit negativ për korrupsionin në drejtësi edhe te organizmat ndërkombëtare.

Por a është i saktë opinionin publik dhe ndërkombëtar që shprehet se gjyqësori i gjithë është i korruptuar? Sipas mendimit tim ky opinion nuk është i saktë dhe as i drejtë, sepse faktet flasin të kundërtën. Sa çështje janë gjykuar e dënuar prej tyre gjatë viteve 2011 – 2012 vërehen si më poshtë:¹³

Viti	Përfunduar hetimet	Dërguar për gjykim	Dënuar
2011	11330	9256	9,071
2012	11654	9354	6,446

Këto të dhëna dëshmojnë më shumë se çdo opinion për të vërtetuar se prokuroritë e gjykatat kanë funksionuar e dënuar shkelësit e ligjit kanë luftuar kriminalitetin. Në rast se ata do ishin të gjithë të korruptuar, siç pretendohet, të pandehurit do të shëtisnin lirshëm dhe nuk do të shkonin në burgje.

¹³ Raport i Prokurorit të Përgjithshëm 2012

Prokurorët e gjyqtarët po kryejnë një funksion shumë të rëndësishëm publik në luftimin e kriminalitetit në tërësi dhe korrupsionit në veçanti. Ata nuk janë e nuk duhet të jenë militantë të kësaj ose asaj force politike, por duhet të jenë luftëtarë të vendosur, guximtarë, të ndershëm, të drejtë e të paanshëm, në dhënien e drejtësisë. Kështu luftohet efektivisht edhe korrupsioni në drejtësi.

Pushteti gjyqësor nuk është e nuk mund të trajtohet si pedale e forcës politike, por është pushteti i tretë i pavarur e i sanksionuar me Kushtetutë dhe si i tillë të respektohet.

Ky është konkluzion kryesor që buron nga faktet e pakundërshtueshme se nuk mund të përgjithësohet e të jepet një opinion se të gjithë prokurorët e gjyqtarët janë të korruptuar dhe as opinioni se pushteti gjyqësor në tërësi është më i korruptuar etj.

Natyrisht, duke bërë këtë konkluzion të përgjithshëm në asnjë mënyrë nuk mohohet se ka prokurorë e gjyqtarë të korruptuar, ashtu sikurse në shëndetësi, në arsim e në administratën publike në përgjithësi, pavarësisht se sa raste janë.

Edhe në vendimet e gjykatave të Tiranës që kanë qënë objekt studimi vërehen raste që ngjallin dyshime serioze për korrupsion, sidomos me ndryshimet e cilësimit juridik të veprave, në vlerësimin e provave e të një anshmërie në arsyetimin e vendimeve etj. U takon organeve më të larta të ushtrojnë kontrolle mbi këto vendime dhe të marrin masat e duhura.

Mendoj se përhapja e këtij opinionit negativ brenda e sidomos jashtë vendit e ka burimin kryesisht në vendimet e Gjykatës së Lartë për Gërdecin, pafajësitë ndaj zyrtarëve të lartë të akuzuar për vepra penale të korrupsionit, ashtu dhe te vendimet e pushimit të Prokurorisë së Përgjithshme për korrupsion, si dhe nga vendimet e gjykatës së Tiranës e të Apelit për çështjen e vrasjes së 21 janarit 2011.

Mjaftojnë këta shembuj negativë që të krijohej ky imazh i gabuar dhe shumë i dëmshëm, të cilin është e domosdoshme të ndreqet nga vetë juristët nga shteti me reforma ligjore, organizative e strukturore

me të gjitha format e mjetet e mundshme por jo duke përmbysur sistemin, siç flitet, sepse sistemi dhe reformat ligjore janë ndërtuar sipas modelit e rekomandimeve të Këshillit të Europës dhe pa nënvlerësuar aspak luftimin e korrupsionit kudo ku shfaqet në prokurori apo gjykatë, të një individi apo të disa prej tyre.

Ky raport studimi jep një ndihmesë në këtë drejtim dhe meriton të vlerësohet.

2.10 Masat parandaluese kundër korrupsionit

Shoqëria shqiptare është e interesuar që më mirë të merren masa parandaluese kundër korrupsionit sesa ai të ndodhë dhe personi të dënohet.

Filozofia popullore: “Dili të keqes përpara” është udhërrëfese për masat parandaluese.

Rekomandimet e Këshillit të Europës vënë në plan të parë parandalimin e korrupsionit duke marrë masa të gjithanshme me reforma shoqërore, ekonomike, arsimore, kulturore në sektorët e tjerë socialë dhe në sistemin e drejtësisë. Me këtë kuptohet parandalimi përgjithshëm.

Në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim e Integrim, zbatimi i përgjithshëm i strategjisë së re antikorrupsion që po përgatitet, synon forcimin e integritetit moral të pushtetit gjyqësor, prokurorisë etj. si dhe të gjyqtarëve, prokurorëve e funksionarëve të tjerë të drejtësisë, i cili përfshin parandalimin e veçantë dhe atë individual.

Masat për parandalimin e korrupsionit në sistemin e drejtësisë merren në radhë të parë nga vetë shteti dhe organet e tij, duke filluar nga policia e shtetit për zbulimin e parandalimin e tij nga prokuroria, e cila nëpërmjet hetimeve zbulon shkaqet e kushtet favorizuese të krimit të korrupsionit dhe nga gjykata si dhe nga organet e larta të drejtësisë. Thellimi i reformave ligjore, organizative e strukturore, shoqëruar me përhapjen e kulturës juridike janë të një rëndësie të veçantë për parandalimin e korrupsionit në drejtësi.

Format, mjetet e metodat që përdoren për parandalimin e

korrupsionit janë të ndryshme e të shumanshme.

Sipas Strategjisë së re që po përgatitet detyrë kryesore është sigurimi i bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të këtyre organeve me organet e tjera shtetërore për marrjen e masave kundër korrupsionit, si dhe bashkëpunimi e bashkëveprimi me OJF-të, shoqërinë civile dhe publikun.

Rekomandim tjetër i rëndësishëm i Këshillit Europian është forcimi i punës edukuese me publikun dhe sidomos me rininë për të rritur vetëdijen e tyre që të denoncojnë çdo rast të korrupsionit në drejtësi. Vendosja e teknologjisë bashkëkohore në Ministrinë e Drejtësisë krijon mundësitë e denoncimeve nga shtetasit të çdo gjyqtari apo prokurori që kërkon apo merr mitë.

Ndihmë të madhe në parandalimin e korrupsionit në gjykata e prokurori apo nga funksionarët e tjerë të drejtësisë mund të japë masmedia, televizioni, shtypi etj.

I padiskutueshëm është edhe roli i avokatëve në parandalimin e korrupsionit në sistemin e drejtësisë.

Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë kanë të gjitha mundësitë që të ndjekin, organizojnë edukimin juridik të publikut me njohjen e ligjeve (nëpërmjet botimeve, seminareve, konferencave etj) në bashkëpunim dhe me fakultetet e drejtësisë publike e private.

Gjithashtu këto organe, nëpërmjet kontrollit administrativ kanë mundësi të parandalojnë korrupsionin dhe të marrin masa disiplinore apo të propozojnë procedimin penal të gjyqtarëve për korrupsion. Po kështu mund të veprojnë edhe Prokuroria e Përgjithshme në sistemin e prokurorisë.

Efektivitetet pozitiv për parandalimin e korrupsionit do të kishte publikimi i vendimeve gjyqësore me të cilat dënohen funksionarët publikë për korrupsion.

Me parandalimin e korrupsionit në sistemin e drejtësisë sigurohet rritja e autoritetit të këtyre organeve, besimi i publikut ndaj drejtësisë, konsolidimi i shtetit të së drejtës dhe zhvillimi i demokracisë. Parandalimi i korrupsionit mbetet kryefjala për luftimin e tij.

3. DISA GJETJE TË STUDIMIT TE VENDIMEVE TE GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE PER VENDIMET E VEPRAVE PENALE TE SHPERDORIMIT TE DETYRES DHE KORRUPSIONIT

Raporte të ndryshëm të organizmave ndërkombëtarë evidentojnë se korrupsioni në Shqipëri është në nivele të larta, veçanërisht në fushën e gjyqësorit, doganave, tatimeve, policisë, shëndetësisë, arsimit, etj.

Rritja e transparencës dhe e besimit të publikut në organet e drejtësisë është një hallkë e rëndësishme e shtetit ligjor. Për shkak të specifikave që paraqesin veprat penale në fushën e korrupsionit dhe pasojave shumë të dëmshme që ato sjellin veçanërisht tek interesat e shtetasve dhe funksionimin normal të Institucioneve shtetëror, organet e drejtësisë duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë zbatimit rigoroz të legjislacionit penal, me qëllim hetimin dhe gjykimin efektiv të këtyre veprave penale.

Në raport progresin e fundit të Komisionit Evropian vërehet se Shqipëria ka shënuar një progres të moderuar lidhur me politikën në luftën kundër korrupsionit. Zbatimi i Strategjisë Anti-korrupsion dhe i masave të veçanta ka vazhduar por me ritme të ngadalta. Gjithashtu, konstatohet progres i mirë në luftën kundër korrupsionit në gjyqësor si rezultat i miratimit të ndryshimeve kushtetuese që kufizojnë imunitetin e gjyqtarëve. Komisioni Evropian konstaton se ka patur progres të moderuar në fuqizimin e kuadrit ligjor në luftën kundër korrupsionit. Në zbatim të disa rekomandimeve të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) u bënë disa ndryshime në Kodin Penal në Mars të vitit 2012, të cilat konsistojnë në ashpërsimin e politikës penale për veprat penale në fushën e korrupsionit.

Duke patur këtë lloj ndjeshmërie, Komiteti Shqiptar i Helsinkit¹⁴


¹⁴ Ky studim është realizuar në kuadër të projektit "Të kontribuojmë në forcimin e zbatimit të ligjit për ndëshkueshmërinë e rasteve të korrupsioni dhe formave të tjera të shpërdorimit të detyrës", zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhembështetur financiarisht nga Fondacioni Soros

ka realizuar një studim të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit gjyqësor të Tiranës me objekt veprat penale të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës.¹⁵ Studimi i vendimeve gjyqësore penale në fushën e korrupsionit, ka patur si qëllim të analizojë nivelin e ndëshkueshmërisë së kësaj kategorie veprash penale duke e parë në këndvështrimin e praktikave të ndjekura nga organi i gjykatës dhe ai i prokurorisë. Në kampionin e vendimeve të studiuara, të cilat kanë shtrirje në periudhën 2007 – 2012, bëjnë pjesë çështje të cilat kanë patur ndjeshmëri të lartë për opinionin publik dhe janë analizuar gjerësisht nga media e shkruar dhe audiovizive për shkak të përfshirjes ose dyshimeve mbi implikimin e funksionarëve të lartë të shtetit, ndëshkueshmëria e të cilëve në vendin tonë është në nivele të ulëta.

Në këtë studim do t'ju prezantojmë disa nga gjetjet kryesore që janë evidentuar gjatë studimit të vendimeve.

3.1 Disa të dhëna sasiore mbi studimin e vendimeve gjyqësore

Nga studimi që KSHH ka realizuar, janë studiuar gjithsej 337 vendime penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, ku janë gjykuar 620 të pandehur në total. Gjithashtu janë studiuar për këto çështje dhe vendime të Gjykatës së Apelit dhe disa të Gjykatës së Lartë.




Grafiku 1 – Të dhëna sasiore mbi vendimet e studiuara

¹⁵ Gjithashtu ky studim ka patur si objekt vetëm vendimet e gjykatave dhe informacioni që paraqitet në këtë tryezë është ai që është perceptuar nga vendimet pa ju futur studimit të dosjeve gjyqësore.

Të dhënat që janë marrë në konsideratë në këtë studim janë të dhëna që lidhen me elementët studimit të vendimeve të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë. Disa herë të dhënave ju kemi referuar me nr vendimesh dhe në raste të tjera me nr të pandehurish.

Nga përpunimi i të dhënave sasiore rezulton se, 574 të pandehur kanë qenë të padënuar më parë nga gjykata, ndërsa 46 kanë qenë të dënuar më përpara, ndërsa për 28 të pandehur nuk ka informacion lidhur me gjëndjen e tyre gjyqësore.

Dhe kjo vihet re dhe si një mangësi e vendimeve gjyqësore në të cilën shpesh mungojnë të dhënat për gjëndjen gjyqësore ose dhe për element të tjerë tepër të rëndësishëm për vendimmarrjen në fund të këtij procesi.



Grafiku Nr. 2. Gjëndja gjyqësore e të gjykuarve ne vendime

Të pandehurit e gjykuar në vendimet objekt studimi janë akuzuar për veprat penale të përmëndura si vijon, ku disa të pandehur janë akuzuar se e kanë kryer në bashkëpunim një vepër penale. Lidhur me kategorizimin e veprave penale, ka patur raste kur të pandehurit janë gjykuar jo vetëm për vepra penale në fushën e korrupsionit por edhe për vepra të tjera penale që lidhen me to, si psh fallsifikimi i dokumentave, vulave, pasaportave, moskallzim krimi, mashtrim, etj.

Nr	NENET (VEPRAT PENALE)	Nr. Pandehurve
1	NENI 135 “Vjedhje duke kryer shpërdorim detyre”	139
2	NENI 164 “Shpërdorim kompetencash”	3
3	NENI 164/a “Korrupsioni aktiv ne sektorin privat”	1
4	NENI 164/b “Korrupsioni pasiv nësektorin privat”	9
5	NENI 244 “Korrupsioni aktiv ipersonave qe ushtrojne funksione publike”	58
6	NENI 245 “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartështetërore ose te zgjedhurve vendor “	3
7	NENI 245/1 “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publik”	40
8	NENI 248 “Shpërdorimi i detyrës”	158
9	NENI 257/a “Refuzimi për deklarimin, ... pasurisë”	19
10	NENI 258 “Shkelja e Barazisë së Pjesëmarrësve në Tendera”	37
11	NENI 259 “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	75
12	NENI 260 “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”	3
13	NENI 319 “Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit & ifunksionareve”	5
14	NENI 319/a “Korrupsioni aktiv igjyqtarit ose izyrtarit te gjykatave nderkombetare”	1

Tabela Nr. 1: Pasqyrimi i numrit të të pandehurve me veprat penale

Për disa dispozita duke përfshirë nenin 244/a dhe kryesisht dispozitat e reja të përfshira në paketën ligjore të ndryshimeve të muajit prill 2012, është vënë re se nuk ka patur vendime të dhëna nga gjykata, ndoshta kjo dhe për shkak të periudhës në të cilën është shtrirë ky studim.

3.2 Masat e sigurisë personale për të pandehurit që janë studiuar vendimet


Ajo që vihet re nga të dhënat e rezultuara nga ky vendime, është se shumica e të pandehurve për këto vepra penale janë gjykuar pa masa të sigurimit personal. Nga studimi është vënë re se kur një pjesë e këtyre të pandehurve kanë patur si masë arrest me burg, kjo masë

nga vendimi rezulton se është ndryshuar në detyrim për paraqitje ose arrest në shtëpi. Kjo ka ndodhur dhe nga ndryshimi i masave nga Gjykatat e Apelit. Duke marrë në konsideratë që një pjesë e tyre janë punonjës në institucionet publike jemi të mendimit se duhet të aplikoheshin më shumë si masa sigurimi garancitë pasurore dhe mbikqyrja elektronike. Shqetësuese është mungesa e informacionit në vendimet e studiuara për masat e sigurimit personal të të pandehurve. Nga studimi i vendimeve ka rezultuar se në disa raste masat e sigurimit personal arrest me burg janë zëvendësuar me ato arrest me shtëpi.

Masat e sigurisë	Nr I te pandehurve
Arrest në burg	89
Arrest në shtëpi	37
Detyrim për paraqitje	32
Garanci pasurore	6
Gjendje të lire (pa masë sigurimi personal)	304
Në mungesë	29
Nuk ka informacion	52
Me disa masa gjatë gjykimit (të ndryshuara)	18


Tabela Nr. 2 – Llojet e masave të sigurimit personal të dhëna për numër të të pandehurve

Ajo që vihet re është se nga 620 të pandehur total, 232 persona të gjykuar janë punonjës në sektorin publik. Për 31 persona nuk ka informacion ndërsa pjesa tjetër janë punonjës në sektorin privat.



Grafiku Nr. 3. Statusi i të pandehurve

Në një kohë që shumica prej personave me funksione publike janë gjykuar në gjendje të lirë pra pa masë sigurie, ndërkohë 25 janë me arrest me burg, ndërsa 28 janë me arrest në shtëpi.



Grafiku Nr. 4 Masat e sigurisë sipas pozicionit të punës

Procesi penal është vënë kryesisht në lëvizje pas denoncimeve të subjekteve si publike dhe private. Institucionet shtetërore që janë hasur në vendimet gjyqësore më së shumti që kanë inicuar procesin janë: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Meteorologjik, Ministri i Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave, Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor, Drejtoria e Shpërndarjes së Energjisë, Zyra e Gjendjes Civile, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, DRSSH. Drejtoria e Policisë Elektrike Tiranë, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e përgjithshme e Metrologjisë dhe ajo e Tiranës.

Gjithashtu të shumta kanë qënë rastet që janë iniciuar nga individët ose subjekte private, të dëmtuar ose jo nga vepra penale. Gjithashtu dhe media ka qënë ajo që kanë vënë në lëvizje mediat. Në njënga rastet e studiuara, procesi është vënë në lëvizje nga përfaqësuesi i një subjekti privat (person juridik), pas denoncimeve në emisionin mediatik investigativ Fiks Fare.


Subjekti që ka vënë në lëvizje procesin penal	Nr I Çështjeve penale
Prokuroria	84
Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm (Sh.K.B)	5
Shërbimi Informativ i Shtetit (Sh.I.Sh)	1
Policia dhe strukturat e saj specifike	12
Institucione publike	26
Instituti i Lartë i Deklarimit dhe kontrollit të pasurisë	18
Kontrolli i Lartë i shtetit	8
Individ (Personat e dëmtuar/kallzues ose të interesuar (fizik apo juridik)	95
N/A (nuk ka informacion)	41

Tabela Nr. 2 Subjektet që kanë vënë në lëvizje procesin penal

3.3 Të dhëna mbi rastet e gjykuara me gjykim të shkurtuar

Nga studimi ka rezultuar se gjykimi i shkurtuar është aplikuar në 60% të të pandehurve të gjykuar. Ajo që është evidentuar është se në 99% të rasteve Gjykata ka pranuar kërkesën e individit për gjykim të shkurtuar me arsyetimin se shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efikasitetin e gjykimit dhe përveç përfitimit prej uljes së 1/3-ës së dënimit, lehtëson ekonominë gjyqësore.

Ka patur shumë raste të evidentuara të cilat për shkak të pranimit të gjykimit të shkurtuar është bërë ndarja e çështjes për të pandehurit duke argumentuar që kjo nuk shkakton asnjë cenim në provat për këtë çështje. Ashtu siç ka rezultuar kur gjykata nuk e ka pranuar ndarjen e çështjes.



Grafiku Nr. 5 Gjykimi i shkurtuar ose i zakonshëm

Por, pavarësisht nga kjo, problematike qëndron pasqyrimi dhe argumentimi në vendimin e publikuar të gjykatës. Kështu në një vendim të studiuar¹⁶ rezultoi se gjykata e ka pasqyruar vetëm në pjesën e dispozitivit të vendimit, aplikimin e gjykimit të shkurtuar, nga ku rezulton se të pandehurve u është ulur 1/3 e dënimit ndërkohë që në pjesën arsyetuese nuk jepet asnjë informacion dhe argumentim lidhur me kërkesën e mbrojtjes, mendimin e prokurorit dhe arsye të kanë çuar gjykatën në marrjen e vendimit të ndërmjetëm.

Pozitive është që gjykata në përgjithësi arsyeton se pohimi i fajësisë nuk është kusht për të proceduar me gjykim të shkurtuar dhe dënimi ulet për shkak të marrëveshjes dhe jo për faktin se ka pranuar apo jo fajësinë, pasi disponimi në lidhje me fajësinë është atribut i gjykatës. Por ka patur disa raste sporadike të cilat bien ndesh me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë Nr. 2 dt 29.1.2003 dhe KPRP-në¹⁷, në të cilat argumentohet nga Gjykata se i pandehuri mban qëndrim mohues ndaj veprës ndonëse kërkoi gjykim të shkurtuar¹⁸.

¹⁶Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 29.02.2012

¹⁷ Kodi I Procedurës Penale

¹⁸ Vendim i Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë, datë 02.12.2010

Pothuajse në shumicën e çështjeve penale të gjykuara objekt i këtij studimi, ku është aplikuar gjykimi i shkurtuar, ka rezultuar që kohëzgjatja e çështjes ka qenë nën mesataren e planifikuar për kategori të caktuara veprash penale, duke lehtësuar dhe shkurtuar procedurat gjyqësore në mënyrë të ndjeshme. Por pavarësisht nga kjo përsëri ka patur çështje që kanë zgjatur me mbi mesataren e kohës për shkak të mungesës së palëve në proces.

Pavarësisht, se sipas praktikës të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, procedura e gjykimit të shkurtuar nuk mund të aplikohet në rastet kur gjykata nuk mund të nxjerrë konkluzione rreth fajësisë apo pafajësisë së të gjykuarit mbi bazën e fashikullit të gjykimit, si dhe në rastet kur vetë i gjykuari heq dorë prej saj, në të kundërt çënohet drejtësia dhe interesat e ligjshme të të pandehurve. Ka rezultuar se jo në të gjitha rastet e pranimit të gjykimit të shkurtuar, Gjykata e rrethit gjyqësor në vendim ka dhënë argumentat e këtij pranimi.

Në vendimet e studiuara rezulton se disa vendime janë formë e prerë, disa janë vendime për të cilat është ushtruar rekurs në Gjykatën e lartë por që nuk kanë marrë një vendim pasi janë në proces studimi.

3.4 Kohëzgjatja e gjykimit

Nga studimi ka rezultuar se minimumi i gjykimit të çështjeve varion nga 30 – 50 ditë ndërkohë që maksimalja -varion deri në 1599 ditë. Ajo që është për t'u evidentuar është se është e vështirë për të kategorizuar sipas vitit kalendarik kohëzgjatjen e çështjes me mesataren e përcaktuar sipas dipsozitetës. Kjo për shkak se dispozita të ndryshme, kohëzgjatjen mesatare të përcaktuar e kanë të ndryshme për vite të ndryshme. Për më tepër që në një pjesë të vendimeve që janë studiuar, ka më shumë se një të pandehur të cilët janë gjykuar për vepra të ndryshme penale por ka dhe raste kur i njëjti i pandehur është gjykuar për më shumë se një vepër penale.

Kohëzgjatja e procesit gjyqësor	Nr. I te pandehurve
1 - 90 dite	125
91 - 180 dite	160
181 dite - 1 vit	164
1 - 2 vjet	141
2 - 3 vjet	13
3 - 5 vjet	17
Total	620

Tabela Nr. 3 – Kohëzgjatja e procesit gjyqësor për numër të të pandehurve

Gjithashtu ka patur raste kur dhe për të njëjtën vepër penale në të njëjtin vit kalendarik, mesatarja e gjykimit është e ndryshme. Pavarësisht formulës së përlllogaritjes së mesatares së gjykimit nga gjykata, janë konstatuar disa raste, kur ka mospërputhje të ndjeshme në përlllogaritjen e kohëzgjatjes mesatare të gjykimit të çështjeve penale në fushën e korrupsionit për vepra penale të njëjta. Për sa më sipër është e vështirë ose nxjerrja e një konkluzioni se sa kanë zgjatur në kohëçështje që i përkasin dispozitave dhe viteve të ndryshme kalendarike.

Por pavarësisht nga kjo, nga një analizë që ne i kemi bërë kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore me ditë kalendarike dhe numër seancash gjyqësore na ka rezultuar:

Konkretisht, një çështje e nenit 135 me 5 të pandehur ka zgjatur 1599 ditë, pra gati 4 vjet e gjysëm dhe një çështje tjetër për 4 vjet me dy të pandehur

Megjithatë, janë konstatuar raste sporadike, ku edhe pse me gjykim të shkurtuar, gjykata ka tejkaluar mesataren e gjykimit të parashikuar për çështjen penale (shembull Vendimi I Gjykatës nr.1263, dt.02.10.2008, kohëzgjatja e gjykimit ka zgjatur 301 ditë, gati 240 ditë mbi mesataren e parashikuar).

3.5 Shkaqet e zvarritjeve të proceseve gjyqësore

Pjesë e këtij studimi janë dhe analizimi i shkaqeve të zvarritjeve të proceseve gjyqësore si një cënim i të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Nga studimi i vendimeve rezultoi se ka shumë çështje të cilat janë në kapërcim të afateve të gjykimit mesatar të përcaktuara nga Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë. Shkaqet kryesore që një pjesë e këtyre proceseve gjyqësore janë mbi afatin mesatar të përcaktuar nga Gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë, janë: 1. *Mungesa e prokurorit në seancat gjyqësore dhe pa dhënë arsye për mungesën*. p.sh në një çështje penale me vendim të datës 27.05.2008, seancat gjyqësore janë shtyrë 14 herë vetëm për mungesë të prokurorit, nga të cilat vetëm një herë prokurori ka kërkuar shtyrjen e seancës. 2. *Mosparaqitja e dëshmitarëve është një shkak tjetër për tejzgjatjen e seancave gjyqësore*. Ajo që vihet re është pasiviteti procedural i gjykatës për shmangien e këtij fenomeni. Nga të gjitha seancat gjyqësore që janë studiuar dhe që janë shtyrë për mosparaqitje të dëshmitarëve vetëm në një rast gjykata ka urdhëruar thirrjen forcërisht të dëshmitarit dhe kjo vërteton pozicionin pasiv të gjyqtarëve gjatë gjykimit të çështjeve. Në shumë raste, dëshmitarët nuk janë paraqitur në gjyq dhe shpeshherë nuk paraqesin as arsye për mungesën; 3. *Mosparaqitja e mbrojtësit* është gjithashtu një shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore, jo të rralla është dhe mosparaqitja e mbrojtësve të të pandehurve. Megjithëse mbrojtësit gjejnë shkaqe procedurale për shtyrjen e seancave gjyqësore, shtyrja e tyre shkakton zvarritje të procesit. 4. Një shkak tjetër është *mosformimi i trupi gjykues, i cili në të shumtën e rasteve ka ndodhur* për arsye personale të gjyqtarëve, seminare trajnuese dhe pjesëmarrja në gjykime të tjera me trup gjykues treshe.

Gjithashtu dhe marrja e provave tek të tretët është një ndër arsyet për shtyrjen e seancave gjyqësore, i cili nuk ndeshet shpesh dhe është një ndër shkaqet që detyrojnë gjykatën, të shtyjë seancën, me qëllim zbatimin e rregullave të një procesi të rregullt ligjor. Në këtë rast gjykata paraqitet e paafte proceduralisht të detyrojë palët e treta, jashtë gjykimit, të paraqesin në gjykim provat e kërkuara nga palët brenda një afati të arsyeshëm.

3.6 Të dhëna mbi politikën penale të ndjekur për personat e gjykuar në vendimet e studiuara

Vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, kanë qënë të ndryshme për sa i përket politikës penale që kanë ndjekur për të pandehurit e gjykuar gjatë periudhës së studimit.

Vendimi i gjyqësorit të rrethit gjyqësor Tiranë	Nr. i te pandehurve
Fajtor	428
I pafajshëm	149
pushim ceshtje	17
Kthim aktet prokurorise neni 377 KPrP	26
Total	620

Tabela Nr. 4 – dispozitivi i vendimit të gjykatës për të pandehurit

Gjithashtu nga 428 persona të shpallur fajtor nga Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë, për 44 prej tyre është vendosur dënim me gjobë, për 138 prej tyre është vendosur burgim dhe për 246 të tjerë është vendosur gjobë dhe burgim. Pra ashtu siç vihet re, shumica e vendimeve të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, kanë dhënë si dënim dhe dënim me gjobë dhe atë me burgim. Dënim i cili sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të korrikut 2012, nuk duhet të aplikohen të dy dënimet.

Llojet e dënimeve	Nr i te pandehurve
Gjobë	44
Burgim	138
Gjobe dhe burgim	246
total	428


Tabela Nr. 5 – Llojet e dënimeve të dhëna nga gjykata

Ajo që vihet re se është se ne të shumtën e rasteve, gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka vendosur minimumin dhe mesataren e dënimit duke e krahasuar atë me dënimin që përmban çdo vepër penale në Kodin penal. Ndërkohë që dënimet maksimale të aplikuara janë në raste shumë të rralla

Nga 232 persona të gjykuar punonjës në sektorin publik janë deklaruar fajtor nga gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë vetëm 144 ndërsa pjesa tjetër të pafajshëm 73, për pjesën tjetër që mbetet ose ka kthim aktesh në prokurori ose janë pushuar. Pra 62% janë deklaruar fajtor nga të pandehurit e gjykuar.

3.7 Aplikimi i dënimeve alternative

Në vendimet penale të studiuara, rezulton se është aplikuar vetëm një lloj dënimi alternative, konkretisht ai i parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal "Pezullimi i Ekzekutimit të Vendimit me Burgim dhe Vënia në Provë". Nga 484 të dënuar me burg dhe me gjobë dhe burgim, për 147 të pandehur është aplikuar dënimi alternative. Të gjithë këtyretë dënuar ju është pezulluar dënimi, me 18 muaj vënie provë max deri në 3 vjet dhe në ndonjë rast të rrallë ka qënë 5 vjet.




Grafiku Nr. 6 Llojet e dënimeve alternative

Përveç detyrimit për të mos kryer veprë tjetër penale, bazuar në nenin 60 të Kodit Penal “Detyrimet e të dënuarit të vënë në provë”, gjykata ka urdhëruar në të shumtën e rasteve që i dënuari të plotësojë detyrimet e mëposhtme gjatë periudhës së provës:


1. Të mos ushtrojë veprimtari profesionale në fushën e mjekësisë;
2. Të mos shoqërohet me persona kryesisht të dënuar;
3. Riparim i dëmit civil (nëçështje të pakta, ndërkohë që pothuajse të gjithave dispozitat kanë në vetvete dëm i sjellë nga veprimet ose mosveprimet)
4. Të mos ushtroje funksione publike (kjo është e pakët gjithashtu)
5. Të mos shoqërohet me persona të dënuar

Ajo që vihet re më së shumti është se dënimet alternative janë dhënë më shumë për ata të pandehur që kanë qënë në gjëndje të lirë. Dhe më pak në ato raste kur kanë qënë arrest në burg ose arrest në shtëpi. Dhe konkretisht paraqitja grafike e mëposhtme e jeq të qartë këtë panoramë.




Grafiku Nr. 7 Dënimet alternative të aplikuara në raport me masën e sigurimit personal për të pandehurit

Nga studimi ka rezultuar se 32% e numrit total të dënimeve alternative janë dhënë për persona që punojnë në institucione shtetërore, ndërsa 66 % për personat që punojnë në subjektet private. Për më shumë shih paraqitjen grafike sa më poshtë:



Grafiku nr. 8 – Aplikimi i dënimeve alternative sipas funksionit të punës të të pandehurit

Nga numri total prej 428 të pandehur të dënuar, vetëm për 53 persona janë dhënë dhe dënime plotësuese përveç dënimit kryesor. Në një kohë që dhe për të pandehurit që kanë ushtruar funksione publike numri i dënimeve plotësuese është shumë i ulët.



Grafiku Nr. 9 Dënimet plotësuese për të pandehurit me funksione publike

Lidhur me aplikimine dënimeve plotësuese të parashikuar nga neni 30 i Kodit Penal, nga vendimet e studiuara rezulton se për një pjesë të të pandehurve përveç dënimit kryesor ka vendosur; Heqja e të drejtës së personit të dënuar për të ushtruar funksione publike për një kohëzgjatje të caktuar; Heqja e të drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridikë; Pezullimi i ushtrimit të funksioneve të avokatit; Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale.

3.8 Ankimi dhe rekursi

Nga vendimet e studiuara rezulton se, vendimet për 348 të pandehur janë ankimuar në Gjykatën e Apelit, pra pak më shumë se gjysma e të pandehurve të gjykuar nga Gjykatat e rrethit gjyqësor Tiranë. Ndërsa për i përket vendimeve të bëra recurs në Gjykatën e Lartë janë në total për 185 të pandehur nga 620 numri total.

Nga vendimmarrja e Gjykatës së Apelit rezulton se: Për 192 të pandehur ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë (54%); Për 7 të pandehur është vendosur nga gjykata e apelit mospranim ankimi; Për 108 të pandehur e ka prishur vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, ndër të cilat në 30 raste e ka pushuar çështjes për mos provim të fajësisë.

Ka rezultuar se në disa vendime gjykata e apelit ka vendosur të prishë vendimin për ta pushuar, për të ulur masën e dënimit, për të rritur masën e dënimit, për të aplikuar dënime alternative ose thjesht një masë më të butë. Në raste të rralla është prishuar për shkak se ka evidentuar shkelje proceduriale ose cënim të procesit të rregullt ligjor. Kjo ka ndodhur në rastet e rikthimit dhe të cilat kanë qënë kryeisht për mosnjohjet në mënyrë të rregullt sipas ligjit; Për 16 të pandehur ka vendosur kthimin për rigjykim në Gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë me një trup tjetër gjykues dhe për pjesën që mbetet nuk ka informacion.


Gjithashtu nga të dhënat e vendimeve na rezulton se në të shumtën rasteve ankimi në Gjykatën e Apelit është bërë nga I pandehuri ose të

pandehurit. Konkretisht sa më poshtë:

Subjekti qe ka bere ankimin	Nr.ankimeve
Prokuroria	62
I pandehuri (për secilin të pandehur)	144
Prokurori & i pandehur	45

Tabela Nr. 6– Subjektet që kanë bërë ankimin

Nga studimi që ju bëmë ankimeve dhe rekurseve të ushturara nga funksionarët public na ka rezultuar se 116 të pandehur kanë ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit dhe 80 të pandehur funksionarë publikë kanë ushtruar recurs në Gjykatën e Lartë. Një pjesë e mirë e rekurseve të ushtuara në Gjykatën e Lartë gjatë studimit të kryer kanë qënë në proces gjykimi.



Grafiku Nr. 9 - Ankimimi i vendimit nga të pandehurit punonjës në sektorin publik

3.9 Argumentimi dhe arsyetimi i vendimeve gjyqësore si dhe qartësia e shkrimit të tyre

Nga studimi i vendimeve vërehet se gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përdorin *teknika të ndryshme në shkrimin e vendimeve*, të cilat jo vetëm nuk janë të unifikuara, por përkundrazi shkaktojnë konfuzion tek lexuesi për të dhënat dhe analizën që duhet të bëhen në një vendim, dhe në mënyrë të veçantë për sa i takon argumentimit të provave të administruara në këtë proces.

Në përqindjen më të lartë të vendimeve të studiuara vërehet *se provat kryesore të administruara* në procesin gjyqësor, një pjesë e të cilave janë formuar në fazën e hetimit në prokurori janë: *transkriptimet nga përgjimet ambientale dhe përgjimet e bisedave telefonike, dëshmitë e dëshmitarëve, leximet e lejueshme të deklarimeve të bëra në prokurori nga kallëzuesi, personi nën hetim, personi që tregon rrethana të hetimit, provat materiale të sekuestruara, aktet e ndryshme të ekspertimit, etj.*

Lidhur me mënyrën se si bëhet *çmuarja e provave nga gjykata* në vendimet e studiuara, e cila në kuptim të nenit 152 të Kodit të Procedurës penale, ka si qëllim përcaktimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre, janë vërejtur praktika të ndryshme. Në disa raste, vlerësimi jo i drejtë i provave të administruara në procesin gjyqësor ose pamjaftueshmëria e tyre për shkak të hetimeve të kufizuara të organit të prokurorisë, ka çuar në pushimin e çështjeve penale ose deklarin e pafajshëm të të pandehurve të akuzuar për kryerjen e veprave penale në fushën e korrupsionit.

Në një vendim gjyqësor të studiuar¹⁹, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë vlerësoi se rezultatet e përgjimit të komunikimeve telefonike hyrëse dhe dalëse të të pandehurve të këtij gjykimi, të vleftësuara, lejuara apo zgjata nga gjykata e rrethit dhe e apelit, duhet të cilësohen të papërdorshme në referim të Nenit 226 të KPrP, pasi nuk janë respektuar dispozitat procedurale në lidhje me përgjimin e fshehtë

¹⁹ Vendim i Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë, datë 23.02.2012

të komunikimeve telefonike. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lejoi përgjimin duke konsideruar si provë të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës në kuptim të neni 222/1 të KPrP-së.

Në pjesën më të madhe të vendimeve të studiuara, nuk bëhet një *analizë e argumentave ligjorë të paraqitur nga palët*. Në këto vendime, gjykata mjaftohet vetëm me parashtrimin e kërkesave përfundimtare të palëve në pjesën hyrëse të vendimit, ku organi i prokurorisë kërkon deklarinin fajtor të të pandehurit për një nga veprat penale në fushën e korrupsionit ose vepra penale të tjera që janë kryer në funksion të tyre, ndërkohë që avokati në të shumtën e rasteve kërkon deklarinin e pafajshëm të të pandehurit dhe në disa raste pushimin e çështjes penale ose deklarinin fajtor duke aplikuar një dënim më të butë. Mospasqyrimi në vendimin gjyqësor i argumentimit ligjor të palëve, prapësimeve të tyre më të rëndësishme që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të legjislacionit penal dhe atij procedural penal, e bën të mangët vendimin e gjykatës në këndvështrimin e këtij studimi.

Analiza e elementëve të figurës së veprës penale në gjykimin e rasteve të korrupsionit, në disa vendime është bërë nëpërmjet një analize të plotë dhe të detajuar të të gjithë elementëve të figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri duke analizuar në mënyrë të veçantë konkretizimin e këtyre elementëve në veprimet apo mosveprimet e të pandehurit.

Në disa vendime të tjera vëmë re se bëhet një analizë formale dhe më shumë doktrinale të elementëve të figurës së veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, duke mos shtjelluar më tej konkretizimin e këtyre elementëve në rastin konkret që është objekt gjykimi. Por janë vënë re gjithashtu dhe vendime të cilat e anashkalojnë analizën e elementëve të figurës së veprës penale dhe mjaftohen me citimin e dispozitës së Kodit Penal që sanksionin këtë vepër penale.

Në pjesën më të madhe të vendimeve të studiuara rezulton se *aplikimi i një dënimi alternativ* kërkohet nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij. Megjithatë, janë vërejtur edhe raste të tjera ku ka qenë organi i prokurorisë që kërkon zbatimin e një dënimit të tillë, duke zbutur në

këtë mënyrë politikën penale për të pandehurit.²⁰ Në raste të pakta sporadike, gjykata ka aplikuar alternativën e dënimit me burgim kryesisht, duke vlerësuar zbatueshmërinë e kushteve të këtij dënimi. Konkretisht, në vendimin nr. 965, dt. 19.06.2012, prokuroria, kërkoi pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim por gjykata dhe ka dhënë një masë dënimi të kërkuar nga prokuroria dhe nuk ka aplikuar dënimin alternativ. Gjkata në një rast tjetër ka krijuar bindjen e brendshme se të dy të pandehurit kanë ndryshuar qëndrimin rreth akuzës duke kërkuar pafajësi dhe duke iu shmangur përgjegjësisë penale, duke mos u ndjerë të penduar për veprën penale të kryer. Refuzimi i dënimit alternativ për këta të pandehur është bërë shkak që Gjykata e Apelit të ndryshojë vendimin dhe të vendosë pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për të dy të pandehurit. Në një kohë qëneni 59 i Kodit penal parashikon ndër të tjerash si kritere për të cilat jepet dënimi alternativ i pezullimit të ekzekutimit të vendimit dhe vënia në provë *“rrezikshmërinë e pakët të personit, moshën, kushtet shëndetësore apo mendore, mënyrën e jetesës dhe ose punën, rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe sjelljen pas kryerjes së veprës penale”*.

Lidhur *me përjashtimin nga dënimi i të pandehurve*, rezulton se gjykata ka vendosur përjashtimin në pak raste dhe kjo ka ndodhur kur këta persona kanë bërë kallëzim dhe kanë dhënë ndihmesën në procedimin penal të këtyre veprave, në zbulimin e veprimtarisë së të pandehurve të tjerë dhe zbardhjen e së vërtetës. Ndërkohë që ka patur raste kur Gjykata pavarësisht se ka qënë në kushtet për të pranuar përjashtimin nga dënimi i personave të caktuar, nuk e ka bërë këtë gjë me arsyetimin se personat nuk kanë bërë kallëzim, nuk përmbushin kriteret, etj. Në rastet kur personat kanë bërë kallëzim pavarësisht se kanë bërë mitdhënie ata janë përjashtuar nga dënimi për shkak se e kanë kallëzuar në prokurori ose në polici një gjë të tillë.

Ajo që vihet re është se gjykatat nuk kanë një qëndrim të unifikuar *në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit* për sa i takon vlerësimin të kritereve të parashikuara në ligj. Në mënyrë të veçantë kjo vihet re

²⁰ Në vendimin Nr. 965, datë 19.06.2012

në vlerësimin që gjykatat i bëjnë rrezikshmërisë shoqërore të veprave penale të njëjta në fushën e korrupsionit dhe të shpërdorimit të detyrës, ku në disa vendime rrezikshmëria e këtyre veprave vlerësohet si e lartë dhe në disa të tjera se nuk ka një rrezikshmëri të madhe. Mungesa e praktikës së unifikuar vërehet edhe në të njëjtin vendim gjyqësor, ku gjykata cilëson me rrezikshmëri relativisht të lartë veprën penale të “ushtrimit të ndikimit të paligjshëm” e cila dënohet nga 6 muaj deri në 4 vjet dhe me gjobë nga 500 000 – 2 milion lek, ndërkohë që vepra penale e shpërdorimit të detyrës klasifikohet me rrezikshmëri shoqërore jo shumë të lartë, vepër e cila dënohet me sanksion deri në 7 vjet burgim dhe me gjobë nga 300 000 – 1 milion lek.

Sanksionet dhe marzhet e dënimit me gjobë dhe burgim të këtyre dy veprave penale nuk kanë ndryshime thelbësore dhe në këtë drejtim, qëndrimi i ndryshëm i gjykatës për vlerësimin e rrezikshmërisë së tyre nuk është i drejtë. Standarte të paunifikuara vërehen edhe në analizën që i bëhet vlerës së përfitimeve nga vepra penale e kryer.

Nuk ka një praktikë të unifikuar të gjykatës për të përcaktuar masën e dënimit mbi bazën dhe të shumës së dëmit që i detyrohet i pandehuri. Sidomos kjo çështje ka të bëjë me praktikën korruptive në prokurimet e fondeve publike për investime me objekt ndërtimin e disa rrugëve. Në këtë çështje janë marrë sitë pandehur funksionarë të lartë të Ministrisë së Transporteve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve. Të gjitha këto prokurime përmbanin ndërtime me vlera relativisht të mëdha financiare. Në këtë vendim nuk analizohet në caktimin e dënimit, vlera e madhe e përfituar nga praktikën korruptive prej të pandehurve dhe dëmi që i shkaktohet shtetit dhe shtetasve. Për një prej të pandehurve gjykata deklaroi se ka përfituar shumën prej 150 000 euro dhe ka marrë një dënim mesatar referuar marzhit minimal dhe maksimal të dënimit. Dhe ndërkohë një të riu që ka kryer një këmbim një shtetase turke me kurs të gabuar, me vlerën përfituese 1600 lekë, dënohet me 1 muaj burgim.

Nga studimi i fakteve të çështjeve penale të ndryshme në fushën e korrupsionit, të cilat pasqyrohen në pjesën arsyetuese të vendimit të

gjykatës, vërehet se ka një firo të numrit të personave që procedohen penalisht nga organi i akuzës në gjykatë. Arsyet janë të ndryshme dhe kanë të bëjnë me mungesën e hetimeve të plota dhe të gjithëanshme nga organi i prokurorisë dhe në disa raste për shkak të mangësive legislative që vërehen në formulimin e veprave penale në fushën e korrupsionit të parashikuara në Kodin Penal.

Gjithashtu ajo që vihet re është se pavarësisht se kemi vendime që dënojnë rastet korruptive sidomos kur ato janë bërë publike dhe janë ende sensitive për publikun, por harrohet më pas që vendimi i formës së prerë është i ai gjykatës së apelit ose i Gjykatës së Lartë në rastin e një rekursi. Për faktin se vendimet e Gjykatës së Lartë kanë vite që presin në rradhë për shqyrtim deri sa ti vijë rradha këtyre çështjeve ato do të jenë harruar nga publiku dhe media.

4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

4.1 Përfundime

1. Raportimet e organizmave ndërkombëtare, analizat e organeve shtetërore, opinionit publik shqiptar dhe raport studimi i vendimeve penale të gjykatave të Tiranës arrijnë në një përfundim të pakundërshtueshëm: se korrupsioni, si fenomen negativ ndërkombëtar përbën problem shqetësues dhe për Shqipërinë në tërësi dhe në sistemin e drejtësisë në veçanti.
2. Luftimi i korrupsionit në sistemin e drejtësisë në mënyrë të gjithanshme ka për qëllim që të goditet fort si plagë shoqërore, sepse dëmton rëndë moralin, ndërgjegjen, interesat jetësore e njerëzore, ligjin, autoritetin e sistemit të drejtësisë, ndërtimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, dhënien e drejtësisë, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut e deri sigurinë kombëtare.
3. Në plan të parë del formimi i një koncepti të drejtë e të qartë se luftimi i korrupsionit në sistemin e drejtësisë nuk bëhet vetëm për të marrë statusin e vendit kandidat në Bashkimin Europian, pa nënvlerësuar dhe rëndësinë e tij politike, por për të shpëtuar autoritetin e drejtësisë dhe për të forcuar besimin e popullit ndaj saj, duke luftuar krimin e korrupsionit që lidhet me krimin e organizuar, pastrimin e parave etj. Për këtë kërkohen reforma nga shteti.
4. Luftimi i korrupsionit në sistemin e drejtësisë nuk realizohet me fushata e retorika politike, por siç theksohet në Progres Raportin e Komisionit Europian, me vullnet të fortë politik, pa ndërprerje, në mënyrë kolektive dhe me masa të gjithanshme parandaluese, edukative, organizative, strukturore, si dhe nëpërmjet zbatimit të dënimit penal, duke vënë para përgjegjësisë penale sidomos funksionarët e lartë publikë si dhe të drejtësisë.

5. Në politikën penale kundër korrupsionit është e papranueshme dhe shumë e dënueshme mosndëshkueshmëria e krimit, pushimi i çështjes apo pafajësia, sidomos për funksionarët e lartë publikë dhe për gjyqtarët, prokurorët e funksionarët e tjerë të drejtësisë.
6. Në studimin e kryer për periudhën 2007 – 2012 të vendimeve gjyqësore për 12 veprat penale për shpërdorimin e detyrës dhe korrupsionit, rezultojnë se janë dhënë 337 vendime gjyqësore me 620 të pandehur në total. Ku pjesa më e madhe e tyre kanë qënë të padënuar më përpara.
7. Personat që janë akuzuar për vepra penale që lidhen me korrupsionin dhe format e shpërdorimit të detyrës, janë akuzuar së bashku dhe me vepra të tjera penale si fallsifikim dokumentave, vulave, pasaportave, etj.
8. Pavarësisht ndryshimeve të Kodit Penal për shtimin e veprave të tjera penale për korrupsionin dhe format e shpërdorimit të detyrës në maj 2012, gjatë studimit nuk janë vënë re vendime për veprat penale të reja, kjo për shkak dhe të periudhës së shkurtër në dispozicion për hetimin dhe më pas gjykimin.
9. Format më të shumta të veprave penale në fushën e korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, janë neni 135 “Vjedhje duke shpërdoruar detyrën” dhe Neni 248 “Shpërdorimi I detyrës” parashikuar në Kodin penal.
10. Për më shumë se gjysmën e numrit të të pandehurve nga gjykata të pandehurit janë lënë pa masë sigurie personal. Për një pjesë të vogël të tyre është dhënë arrest në burg.
11. Pothuajse më pak se gjysma e numrit të të pandehurve janë persona që punojnë në sektorin publik dhe pjesa më e madhe e tyre janë gjykuar në gjëndje të lirë.

12. Në më shumë se 60% të rasteve është zhvilluar gjykim i shkurtuar, pavarësisht se praktika gjyqësore në këto raste ka ndjekur atë që përcaktohet në vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë.
13. Proceset gjyqësore për vepra penale në fushën e korrupsionit dhe formave të tjera të shpërdorimit të detyrës kanë zgjatur në të shumtën e rasteve nga 3 muaj në 1 vit. Por nuk mungojnë dhe rastet që shkojnë deri në 3 vjet gjykim.
14. Në krahasim me numrin total të të pandehurve, 62% prej tyre janë shpallur fajtor dhe në të shumtën e tyre është dhënë dënim me gjobë ose dënim alternativ. Dënimi alternativ më i përdorur nga gjykata është neni 59 I Kodit penal.
15. Çështja për rreth gjysmës së të pandehurve të gjykuar është ankimuar në Gjykatën e Apelit e cila në më shumë se 54% të ankimeve ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.
16. Praktikrat e ndjekura nga gjyqtarët në çështje të ngjashme është e ndryshme dhe krijon precedent të ndryshëm në jurisprudencën gjyqësore. Nuk ka një praktikë të unifikuar të gjykatës për të përcaktuar masën e dënimit mbi bazën dhe të shumës së dëmit që i detyrohet i pandehuri.

4.2 Rekomandime

1. Do të rekomandonim rishikimin e Kodit penal dhe Kodit të Procedurës Penale lidhur me parashikimin e këtyre dispozitave me qëllim rritjen e efektshmërisë të ndëshkueshmërisë së këtij fenomeni. Të bëhen ndryshime në nenin 245/1 dhe 248 të Kodit Penal, ku të parashikohet përgjegjësia penale e personave të tretë që kanë përfituar me dashje nga ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ose shpërdorimi i detyrës së funksionarit publik.

2. Në zbatim të detyrave për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit janë një varg masash të tjera konkrete që duhen marrë, konkretisht të përmirësohen mekanizmat dhe mjetet për hetimin e rasteve të korrupsionit, në mënyrë të veçantë teknikat e hetimeve të veprave penale në fushën e korrupsionit dhe në mënyrë të veçantë ato teknika që kanë të bëjnë me gjetjen dhe marrjen e provave.
3. Të tregohet vullnet serioz efektiv politik i drejtuesve të shtetit për të luftuar e parandaluar korrupsionin me reforma ligjore, strukturore, organizative në sistemin e drejtësisë dhe veçanërisht respektimi rigoroz i parimeve kushtetuese të pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Larg presioneve e ndërhyrjeve politike në gjykatë e prokurori për të mbrojtur funksionarët e korruptuar.
4. Rekomandojmë qëndrueshmëri, guxim, ndërgjegje, ndershmëri, transparencë, përgjegjshmëri, karakter, vullnet, dinjitet, nga çdo gjyqtar e prokuror për sundimin e ligjit kundër korrupsionit. Profesionalizëm i lartë i të gjithë gjyqtarëve e prokurorëve në realizimin e detyrës, do të përmirësojë në dhënien e drejtësisë dhe luftimin e korrupsionit.
5. Rekomandohet që të merren masa të gjithanshme për përgatitjen me kualifikim të lartë të juristëve të përgatitur brenda vendit dhe angazhimi maksimal i juristëve që janë përgatitur jashtë vendit.
6. Rekomandojmë marrjen e masave të shumanshme efektive – reforma ligjore, forcim i kontrollit dhe edukim i gjerë i publikut për të denoncuar kundër korrupsionit e të korruptuarve në gjykatë, prokurori apo funksionarëve të tjerë të drejtësisë.
7. Organet e drejtësisë penale (polici, prokurori, gjykatë) duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë zbatimit rigoroz të legjislacionit penal, me qëllim hetimin dhe gjykimin efektiv të

këtyre veprave penale. Si dhe të rritet numri i çështjeve penale të hetuara kryesisht nga organi i prokurorisë

8. Organi i prokurorisë të mos bëhet shkak për shtyrjen dhe zvarritjen e paarsyetuar të seancave gjyqësore të çështjeve penale në fushën e korrupsionit
9. Të formulohet akuza e ngritur nga prokuroria për veprat penale në fushën e korrupsionit, duke bërë një analizë të plotë të elementëve të anës objektive dhe subjektive të Veprës Penale dhe në harmoni me provat e rezultuara nga hetimet, me qëllim që të mos kemi pushim të çështjeve penale me arsyetimin nga gjykata se fakti nuk përbën vepër penale apo se provat nuk vërtetojnë akuzën e ngritur.
10. Të merren në përgjegjësi penale nga organi i akuzës dhe të përjashtohen nga vuajtja e dënimit të gjithë ata persona që kanë bërë kallëzim ose kanë bashkëpunuar me organet e procedimit penal për një nga veprat penale të parashikuara në nenin n.245/2 të K.Penal.
11. Organet e policisë të ofrojnë ndihmë të shpejtë dhe efektive në gjetjen dhe shoqërimin e detyrueshëm të dëshmitarëve të thirrur për çështjet penale të korrupsionit
12. Të kërkohet marrja e masave ndëshkimore pranë Dhomave përkatëse të Avokatisë në rastet e shtyrjeve të seancave gjyqësore për shkak të shtyrjeve të paarsyetuara të seancave gjyqësore;
13. Shkolla e Magjistraturës duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë shkrimit të vendimeve gjyqësore për veprat penale në fushën e korrupsionit, në mënyrë të veçantë:
 1. të parashtrohen argumentimet ligjore të palëve dhe të jepen argumenta bindëse për pranimin ose refuzimin e tyre

2. të pasqyrohen në mënyrë të plotë të gjitha provat që ka në qenë vendimtare në krijimin e bindjes së brendshme të gjyqtarit;
 3. të bëhet përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të provave dhe analizë e plotë e provave që japin fakte kontradiktore.
 4. të analizohen elementët e anës objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri duke bërë gjithmonë konkretizimin e këtyre elementëve në veprimet dhe mosveprimet e tij;
 5. të analizohen kriteret dhe rrethanat që janë patur parasysh në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit kryesor, plotësues dhe dënimit alternativ duke bërë gjithmonë individualizimin e dënimit në raport me veçoritë që paraqet i pandehuri;
14. Një ndër rekomandimet në këtë kuadër do të ishte për dhënien më shumë të masave të sigurimit personal si garanci pasurore dhe mbikqyrje elektronike.
 15. Të mos anashkalohen në caktimin e dënimit rrethana të tilla si pasojat e dëmshme që kanë sjelle në buxhetin e shtetit dhe interesat e qytetarëve veprat penale korruptive dhe kryerja e veprës penale në bashkëpunim.
 16. Në çdo rast kur i pandehur deklarohet fajtor për kryerjen e veprave penale në fushën e korrupsionit në sektorin publik të aplikohet dënimi plotësues për ndalimin e ushtrimit të funksioneve publike.
 17. Të unifikohet praktika gjyqësore në aspektin doktrinal për sa i takon vendosjes së kriteve në përcaktimin e nivelit të rrezik-

shmërisë së veprave penale në fushën e korrupsionit, me qëllim që gjykatat të mos përdorin standarte të dyfishta në këtë drejtim;

18. Për këtë arsye do të rekomandimin që Shkolla e Magjstratures të vazhdojë trajnimet së bashku me organizmat ndërkombetare të Njësive të përbashketa të hetimit për këtë grup veprash penale si dhe trajnime vazhduese për gjyqtaret për unifikimin e shkrimit dhe arsyetimit të vendimit.